



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS- VLADA KOSOVA- GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË-AGENCIJA ZA RAZVOJ POLJOPRIVREDE AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT			
Hjësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	07/4	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	3366
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	142	Data Datum Date	15.06.2020
PRISHTINE/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë /Agencija za Razvoj Poloprivrede /Agriculture
Development Agency

Raporti

Vjetor i Punës për Vitin 2019



Përmbajtja

Lista e Tabelave dhe Grafikoneve	III
Lista e figurave	VI
Akronimet:.....	VII
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	1
Logjistika	4
Sektori ligjor.....	5
Arkiva.....	8
Zyra e informimit	10
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	12
DREJTORIA I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL	13
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore	13
Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	13
Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	13
Masa: Ujitja e tokave bujqësore.....	14
Masa 303: LEADER Zbatimi i strategjive zhvillimore locale - qasja Leader	14
Procedurat e zbatimit të Projekteve të Zhvillimit Rural	18
Faza e aplikimit	18
Shqyrtimi administrativ, vlerësimi, kontrolli në teren dhe Miratimi i Projekteve të Zhvillimit Rural	24
DREJTORIA E AUTORIZIMIT TË PAGESAVE	31
Hyrje.....	31
Aktivitetet e realizuara për Autorizimin e Pagesave	32
Aktivitetet tjera të Drejtorisë së Autorizimit	47
Shqyrtimi i raporteve të EX POST kontrollit për vitin 2015 dhe 2016	48
Vështirësitë gjatë implementimit të programit të vitit 2019	48
Nevojat e DAP-it për mbështetje në staf dhe teknologji informative.....	49
DREJTORIA E PAGESAVE DIREKTE	51
Pagesat Direkte për mbjellje vjeshtore - Grurë	51
Pagesat Direkte - Farë Gruri	52
Pagesat Direkte - Misër.....	53
Pagesat Direkte - Elb	54
Pagesat Direkte - Thekër	55
Pagesat Direkte - Tërshërë.....	56
Pagesat Direkte për bimë vajore - Luledielli.....	57
Pagesat Direkte - Perime	58
Pagesat Direkte - Pemishte ekzistuese	59
Pagesat Direkte - Mjedër / kg.....	60
Pagesat Direkte - Vreshtari.....	62
Pagesat Direkte - Bujqësi Organike.....	63
Pagesat Direkte për Blegtori - Lopë Qumështore.....	63
Pagesat Direkte për Blegtori - Buallica.....	65
Pagesat Direkte për kafshë të imta - Dele dhe Dhi.....	65
Pagesat Direkte - Bletë.....	68
Pagesat Direkte - Thëllëza.....	69
Pagesat Direkte - Material fidanor.....	69

Pagesat Direkte – Pula vojse	70
Pagesat Direkte – Dosa	71
Pagesat Direkte – Verë e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht.....	72
Pagesat Direkte – Qumësht sipas cilësisë gjashtëmujori i parë 2019	73
Pagesat Direkte – Qumësht sipas cilësisë gjashtëmujori i dytë	74
Pagesat Direkte – Therrjet e Raportuara të Gjedhit, gjashtëmujori i parë 2019.....	75
Pagesat Direkte – Therrjet e Raportuara të Gjedhit, gjashtëmujori i dytë 2019.....	76
Pagesat Direkte – Akuakulturë gjashtëmujori i parë 2019	76
Pagesat Direkte – Akuakulturë gjashtëmujori i dytë, 2019	76
Përmbledhje e raportit për Pagesa Direkte 2019.....	77
DREJTORIA E KONTROLLIT	79
Hyrje.....	79
Aktivitetet e zhvilluara vjetore	79
Resurset në dispozicion të Drejtorisë së Kontrollit	81
Resurset Humane në Shërbim të Drejtorisë së Kontrollit	81
Resurset Tekniko – Logjistike në shërbim të Drejtorisë së Kontrollit.....	83
Kontrolli i lëndëve për Pagesa Direkte	84
Kontrolli i Kulturave Lavërtare	85
Vështirësitë në kontrollin e pagesave direkte.....	92
Kontrolli i lëndëve për Projektet e Zhvillimit Rural – Grantet.....	93
Vazhdimi i kontrollit në teren i Projekteve të vitit 2018 të bartura në vitin 2019	93
Kontrolli i Projekteve për masat mbështetëse të zhvillimit rural - 2019.....	94
Vështirësitë gjatë kontrollit në teren për Projektet e Zhvillimit Rural	107
Të arritura	108
Konkluzionet dhe rekomandimet	109
Përfundimi	110
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (IT)	111
Hyrje.....	111
Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)	114
Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS).....	118
Regjistri i Granteve.....	124
Regjistri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë	124
Miratimi i granteve	125
Autorizimi i Pagesave.....	126
Moduli i kontrollit në teren	127
Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte	128
Softueri për Indikator	130
Ueb faja.....	131
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM	132
Detyrat e auditimit	132
Auditimet sipas Planit Vjetor të Auditimit.....	132
Auditimet me kërkesë nga menaxhmenti.....	133
Detyrat e konsulencës	134
Të tjera.....	134

Lista e Tabelave dhe Grafikoneve

Tabela 1: Numri i punëtorëve gjatë vitit 2019 në AZHB	3
Tabela 2: Struktura profesionale e të punësuarve në AZHB	3
Tabela 3: Struktura Gjimore e të punësuarve në AZHB	3
Tabela 4: Raporti vjetor i shpenzimeve të karburanteve, 2019	5
Tabela 5 Ankesat, kërkesat dhe vendimet	9
Tabela 6: Numri i kërkesave të pranuar	10
Tabela 7: Kërkesat e paraqitura	10
Tabela 8: Mënyra e dërgimit të përgjigjeve	10
Tabela 9: Profili	11
Tabela 10: Publikimet në ueb	11
Tabela 11: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore – Sektorët	15
Tabela 12: Grafikoni 1 - Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore - Sipas sektorëve	15
Tabela 13: Masa 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore -Sektorët përkatës	15
Tabela 14: Grafikoni 2- Masa 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore - Sektorët përkatës.	16
Tabela 15: Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	16
Tabela 16: Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale	16
Tabela 17: Masa 303 LEADER Zbatimi i strategjive zhvillimore locale – qasja Leader	17
Tabela 18: Grafikoni 4 – Masa 303 LEADER Zbatimi i strategjive zhvillimore locale - qasja Leader	17
Tabela 19: Ujitje e Tokave Bujqësore	17
Tabela 20: Programi i Veçantë	17
Tabela 21: Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore – Sektorët	18
Tabela 22: Programi i Veçantë – Integrimet Socio ekonomike	18
Tabla 23: Masa 101- Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në € sipas sektorëve	19
Tabela 24: Masa 103- Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në € sipas sektorëve	19
Tabla 25: Grafikoni 5 – Nr. i aplikacioneve për Masën 103	20
Tabela 26: Masa 302 - Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në € sipas sektorëve	20
Tabela 27: Grafikoni 6- Nr. i aplikacioneve për Masën 302	21
Tabela 28: Masa 303 Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në €	21
Tabela 29: Masa Ujitja e tokave bujqësore	22
Tabela 30: Numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar në € Programi i veçantë - Integrimet Socio-Ekonomike për fermat e vogla	22
Tabela 31: Gjithsejt numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për të gjitha masat gjatë vitit 2019	23
Tabela 32: Grafikoni 7 - Gjithsejt numri i aplikacioneve dhe vlera e aplikuar për të gjitha masat gjatë vitit 2019	23
Tabela 33: Nr. i aplikacioneve të miratuara /kontraktuara dhe vlera e miratuar/kontraktuar e projekteve për vitin 2019 sipas nën masave dhe sektorëve përkatës	25
Tabela 34: Numri i aplikacioneve në PZHR gjatë viteve (sipas sektorëve përkatës) 2015, 2016 ,2017, 2018 dhe 2019	27
Tabela 35: Grafikoni 8- Numri i aplikacioneve në PZHR gjatë viteve (sipas sektorëve përkatës) 2015, 2016 ,2017, 2018 dhe 2019	27
Tabela 36: Vlera e aplikuar në sektorët përkatës në PZHR 2015-2016-2017-2018-2019	28
Tabela 37: Grafikoni 9 - Vlera e aplikuar në sektorët përkatës në PZHR 2015-2016-2017-2018-2019	29
Tabela 38: Numri i projekteve të përkrahura sipas viteve 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019	30
Tabela 39: Grafikoni 10- Numri i projekteve të përkrahura sipas viteve 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019	30
Tabela 40: Obligimet e Kontraktuara nga viti 2018 të bartura në vitin 2019	33
Tabela 41: Nrumri dhe vlera e projekteve të autorizuara nga programi i vitit 2018 në vitet 2018/2019	34

Tabela 42: Grafikoni nr. 11- Nr i Projekteve të Autorizuara të Masës 101 në total për vitin 2018	35
Tabela 43: Grafikoni nr. 12 - Vlerat e projekteve të Autorizuara të Masës 101 në total për vitin 2018	35
Tabela 44: Grafikoni nr. 13 - Numri i Projekteve të autorizuara nga programi i vitit 2018 në vitin 2019 për Masën 101	35
Tabela 45: Grafikoni nr 14: Vlera e projekteve të Autorizuara nga programi i vitit 2018 në vitin 2018-Masa 101	36
Tabela 46: Grafikoni nr.15 - Numri i projekteve të Autorizuara nga Programi i vitit 2018 në vitin 2019- Masa 302	36
Tabela 47: Grafikoni nr. 16 - Vlera e projekteve të Autorizuara nga Programi i vitit 2018 në vitin 2019- Masa 302	36
Tabela 48: Grafikoni nr. 17: Numri i projekteve të Autorizuara nga Programi i vitit 2018 në vitin 2019- Masa 103 (kësti i dytë)	37
Tabela 49: Grafikoni nr. 18 - Vlera e projekteve të Autorizuara nga Programi i vitit 2018 në vitin 2019 Masa 103 (kësti i dytë)	37
Tabela 50: Grafikoni nr.19 - Numri i projekteve të Autorizuara nga Programi i vitit 2018 në vitin 2019 Masa e Veçantë (kësti i dytë)	37
Tabela 51: Grafikoni nr. 20 - Vlera e projekteve të Autorizuara nga Programi i vitit 2018 në vitin 2019 Masa e Veçantë (kësti i dytë)	38
Tabela 52: Projektet e Autorizuara nga Programi i vitit 2019	39
Tabela 53: Obligimet e kontraktuara të vitit 2018 / 2019 të bartura në vitin 2020	40
Tabela 54: Numri i projekteve të miratuara dhe të Autorizuara nga Masa 101 për programin e vitit 2019	41
Tabela 55: Grafikoni 21: Numri i projekteve të miratuara dhe autorizuara nga programi i vitit 2019	42
Tabela 56: Vlera e projekteve të miratuara dhe të Autorizuara nga Masa 101 për programin e vitit 2019	42
Tabela 57: Grafikoni nr. 22 - Vlera e projekteve të miratuara dhe autorizuara nga programi i vitit 2019	43
Tabela 58: Numri i projekteve të miratuara dhe të Autorizuara nga Masa 302 për programin e vitit 2019	43
Tabela 59: Grafikoni nr. 13 - Numri i projekteve të miratuara dhe autorizuara nga programi i vitit 2019 për Masën 302	43
Tabela 60: Vlera e projekteve të miratuara dhe të Autorizuara nga Masa 302 për programin e vitit 2019	44
Tabela 61: Grafikoni nr. 14 - Vlera e projekteve të miratuara dhe autorizuara nga programi i vitit 2019 për Masën 302	44
Tabela 62: Numri i projekteve të Miratuara dhe Autorizimi i paradhënies për Masën 103 për programin e vitit 2019	44
Tabela 63: Grafikoni nr. 25 - Numri projekteve të miratuara dhe autorizimi i paradhënies nga programi i vitit 2019 për Masën 103	45
Tabela 64: Numri i projekteve të Miratuara dhe Autorizimi i Paradhënies për Masën 103 për programin e vitit 2019	45
Tabela 65: Grafikoni nr. 16 - Vlerat e projekteve të miratuara dhe autorizimi i paradhënies nga programi i vitit 2019 për Masën 103	45
Tabela 66: Numri i projekteve të Miratuara dhe Autorizimi i Paradhënies për Masën 303 dhe Ujitje për programin e vitit 2019	46
Tabela 67: Vlerat e projekteve të Miratuara dhe Autorizimi i Paradhënies për Masën 303 dhe Ujitje për programin e vitit 2019	46
Tabela 68: Grafikoni nr. 28 - Vlera e projekteve të Miratuara dhe Autorizimi i paradhënies nga programi i vitit 2019 për Masën 303 dhe Ujitjes	46
Tabela 69: Ex Post Kontrolla për përfituesit e vitit 2015/2016	48
Tabela 70: Përfituesit, të refuzuarit, sipërfaqja e subvencionuar dhe refuzuar dhe shuma e pagesës sipas komunave, PD-Grurë 2019	52
Tabela 71: Përfituesit dhe sipërfaqja e subvencionuar për prodhuesit e farës së grurit sipas komunave, 2019	53
Tabela 72: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave - misër 2019	54

Tabela 73: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Elb 2019	55
Tabela 74: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Thekër 2019	56
Tabela 75: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Tërshërë 2019	57
Tabela 76: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Luledielli 2018	58
Tabela 77: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Perime 2019	59
Tabela 78: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Pemishte ekzistuese 2019	60
Tabela 79: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Mjedër / kg 2019	62
Tabela 80: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Vreshta ekzistuese 2018	62
Tabela 81: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – bujqësi organike 2019	63
Tabela 82: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe krerët e subvencionuar sipas komunave – lopë qumështore 2019	65
Tabela 83: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe krerët e subvencionuar sipas komunave – Buallica 2019	65
Tabela 84: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe krerët e subvencionuar sipas komunave – Dele 2019	66
Tabela 85: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe krerët e subvencionuar sipas komunave – Dhi 2019	67
Tabela 86: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kosheret e subvencionuara –Bletë 2019	69
Tabela 87: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe krerët e subvencionuara –Thëllëza 2019	69
Tabela 88: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i fidanëve të subvencionuar sipas komunave, 2019	70
Tabela 89: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i pulave të subvencionuara sipas komunave, 2019	71
Tabela 90: Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i dosave të subvencionuara sipas komunave, 2019	72
Tabela 91: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Verë e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, 2019	72
Tabela 92: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Qumësht sipas cilësisë gjashtëmujori i parë, 2019	74
Tabela 93: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Qumësht sipas cilësisë gjashtëmujori i dytë, 2019	75
Tabela 94: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Therret e raportuara të gjedhit, gjashtëmujori i parë, 2019	75
Tabela 95: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Therret e raportuara të gjedhit, gjashtëmujori i dytë, 2019	76
Tabela 96: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Akuakulturë, gjashtëmujori i parë, 2019	76
Tabela 97: Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Akuakulturë, gjashtëmujori i dytë, 2019	76
Tabela 98: Shumat e paguara sipas sektorëve për Pagesa Direkte për vitin 2019	78
Tabela 99: Grafikoni nr. 29: Shumat e Pagesave Direkte për vitet 2017-2019	78
Tabela 100: Numri dhe vendi i sistemimit të të punësuarve në Drejtorinë e Kontrollit	83
Tabela 101: Numri i Aplikantëve për Pagesa Direkte, Numri i Aplikantëve të Kontrolluar dhe shprehja	88
Tabela 102: Numri i kontrolleve të realizuara për Pagesa Direkte nga inspektorët individualisht	90
Tabela 103: Rrjedha e Numrit të Kontrolleve në vitet 2013 - 2019.	90
Tabela 104: Grafiku 1- Tregon uljen e kontrollit për Aplikant dhe rritjen e kontrollit për Masa / Kultura	90
Table 105 Numri Total i Kontrolleve të Projekteve të Zhoillimit Rural gjatë vitit 2019.	94

Tabela 107: Grafiku 30 - Pasqyrimi i kontrollit PZHR, në % gjatë vitit 2019	94
Tabela 108: Kontrolltet e para (para miratimit PZHR- 2019)	95
Tabela 109: Grafiku 31 - Kontrolltet për PZHR 2019 sipas masave në %:	96
Tabela 110: Kontrollta e dytë (para Pagesës për PZHR- 2018 të kryera në vitin 2019)	98
Tabela 111: Grafikoni 32 - Kontrolltet e dyta (para Pagesës për PZHR- 2018 të kryera në vitin 2019) të paraqitura në %.	99
Tabela 112: Kontrolltet e dyta (para Pagesës PZHR- 2019 të kryera në vitin 2019) të paraqitura në kornizë kohore	100
Tabela 113: Grafikoni 33 - Kontrolltet e dyta para pagesës të shprehura në përqindje	101
Tabela 114: Grafikoni 34 - Dinamika dhe Korniza Kohore e zbatimit të Kontrolleve të PZHR-ve në vitin 2019	103
Tabela 115: Krahasimi i numrit të kontrolleve sipas kategorive 2019 dhe 2018	103
Tabela 116: Grafikoni 35 - Krahasimi i numrit të Kontrolleve sipas kategorive për PZHR 2019 dhe 2018	104
Tabela 117: Numri i lëndëve të PZHR të përfunduara nga secili Inspektor veç e veç.	105
Tabela 118: Numri i lëndëve të përfunduara nga PZHR dhe PD, për secilin inspektorë	107
Tabla 119 Numri total i aplikanteve të kontrolluar gjatë vitit - 2019	108
Tabla 120 Grafikoni 35 Numri i fermereve në vite	115
Tabela 121: Grafikoni 36 - Numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS, numri i parcelave dhe sipërfaqja e digjitalizuar nepër vite	122
Tabela 122: Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet sipas Planit Vjetor	133
Tabela 123: Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet me kërkesë	133

Lista e figurave

Figura 1: Organogrami i AZHB-së	2
Fig. 2 - Skema e lidhjes së regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)	112
Fig. 3 - Sistemi i komunikimit të AZHB-së, baza e të dhënave të AZHB-së si dhe komunikimi i rrjetit në mes AZHB-së me ASHI	113
Fig. 4 - Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR	116
Fig. 5 - Regjistri Elektronik i Fermereve	117
Fig. 6 sLPIS dhe ndërlidhja me Agjencinë Kadastrale përmes Geoportalit	118
Fig. 7 Funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE	119
Fig. 8 Sistemi i Thjeshtesuar për Identifikim të Parcelave të Tokës (sLPIS)	122
Fig. 9 sLPIS-Mobile	123
Fig. 10 Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë	124
Fig. 11 Softuerin për miratimin e granteve	125
Fig. 12 Softuerin për autorizimin e pagesave	126
Figura 13 Moduli i kontrollit në teren	127
Fig. 14 Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte	128
Fig. 15 Aplikacionin për aplikim për Pagesa Direkte	129
Figura 16 Softuerin për indikator	130
Fig. 17 Ueb Faqja	131

Akronimet:

AZHB - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

AM - Autoriteti Menaxhues

BB - Banka Botërore

BE - Bashkimi Europian

DAP - Departamenti i Administratës së Përgjithshme

PZHR - Projektet e Zhvillimit Rural

PD - Pagesat Direkte

AP - Autorizimi i Pagesave

TI - Teknologjia e Informacionit

ZK - Zyra e kontrollit

ZR - Zyret Regjionale

LPIS - Sistemit të Integruar të Manaxhimit dhe Identifikimit të Parcelave

MF SIMFK - Ministria e Financave, Sistemi i Menaxhimit të Financave Kosovë

APK - Agjencia e Pyjeve të Kosovës

AUK - Agjencia e Ushqimit të Kosovës

OE - Operatoret Ekonomik

U/A - Udhëzues Administrativ

PZHR - Projektet e Zhvillimit Rural

DAPZHR - Drejtorati i Autorizimit të Pagesave për Projektet e Zhvillimit Rural

NIF - Numri Identifikues i Fermë

SAB - Sektori i Auditimit të Brendshëm

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-090 për ndryshim plotësim të Ligjit me nr. 03/L-98 si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është përgjegjëse për implementimin e programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke zbatuar rregulloret dhe procedurat e shkruara për implementimin e Pagesave Direkte dhe Projekteve për Zhvillim Rural.
- Duke u bazuar në kërkesat e IPARD II dhe kërkesat e kohës, nevojën për avansimin e AZHB-së gjatë këtij viti, kemi arritur që të punojmë në plotësimin e të dhënave të stafit në sistemin e SIMBNJ të cilin sistem e menaxhon MAP-I;
- Kemi punuar në Rregulloren e Brendshme të AZHB-së sipas marrëveshjes kornizë në mes Qeveris së Republikës së Kosovës dhe BE –së për të cilën është kusht edhe akreditimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Jemi në përpjekje edhe për krijimin e Drejtorisë së Koordinimit me zyret regjionale si dhe Sektori i Kontrollit të Brendshëm;
- Jemi në përpjekje të vazhdueshme për finalizimin e plotësimit me kapacitete të Burimeve Njerëzore sipas rekomandimeve dhe kërkesës së IPARD II;
- Gjatë këtij viti jemi bartur nga objekti i ish Bankës së Lubljanës në lagjen “Ramiz Sadiku” brenda një periudhe të shkurtër;
- Edhe këtë vit vazhdojmë të ballafaqohemi me mungesë të hapësirës fizike për vendosjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të Sektorit të Arkivës;
- Po ashtu kemi mungesë të paisjeve elektronike (skaner, printer, kompjuter) si në objektin Bazë po ashtu edhe në zyret regjionale;
- Vazhdojmë të përballemi me probleme të shumta me objektet e Zyreve Regjionale, me theks të veçantë të atyre të cilat i kemi të marrura me qera dhe që nuk ofrojnë kushte esenciale duke përfshirë mungesën e mjaftueshme të hapësirës brenda zyreve dhe mungesën e parkingjeve për automjetet zyrtare;
- Drejtoria e Administratës ka kërkuar nga Komunitat e vendit, që t’na siguroj objekte (pronë shoqërore) AZHB-së në mënyrë që të evitohen pagesat ndaj zyreve të marrura me qera. Ndonëse deri më tani asnjë Komunë nuk ka kthyer përgjigje pozitive mbase disa prej tyre nuk na u kanë përgjigjur fare;
- Menaxhimi i dosjeve elektronike të fermerëve po ashtu është në nivel të kënaqshëm;
- Menaxhimi i automjeteve dhe paisjeve tjera për kontrollin në teren është në gjendje të kënaqshme.




Figura 1: Organogrami i AZHB-së

AZHB sipas propozim - organogramit të ri i cili është në përputhje me kërkesat e IPARD II do të ketë tetë drejtori, ku shtatë prej tyre janë funksionale, ndërsa një pritet të themelohet si dhe Sektori i Kontrollit të Brendshëm (shkaku i mungesës së stafit). Sipas këtij organogrami sektorët ende janë duke funksionuar si Zyre Rajonale për shkak të mungesës së stafit.

Edhe gjatë këtij viti, AZHB-ja është përballur me mungesë të madhe të stafit për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara për implementimin e programeve. Andaj për plotësimin e nevojave me zyrtarë edhe këtë vit kemi qenë të detyruar të rekrutojmë 9 (nëntë) zyrtarë me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta dhe 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) zyrtarë me mbështetje nga Marrëveshja në mes MBPZHR-së dhe MPMS-së.

Në fillim të vitit 2019-të kanë qenë të punësuar 65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës të rregullt të lejuar me kodin buxhetor dhe deri në fundvit kemi arritur t'i rekrutojmë edhe 4 (katër) zyrtarë. Deri më tani janë gjithësej 68 (gjashtëdhjetë e tetë) zyrtarë po aq sa janë të lejuar me buxhet.

Gjatë këtij viti kemi transferuar edhe një zyrtarë nga MBPZHR, ku duhet të bartet edhe me buxhet. Po ashtu 1 (një) pozitë e kemi publikuar në vijën buxhetore të MBPZHR-së 1130.

Muajt	Punëtor të rregullt	KSHV	Marrëveshje	Totali
Janar	65	22	00	87
Qershor	68	19	44	131
Dhjetor	68	28	67	163

Tabela 1: Numri i punëtorëve gjatë vitit 2019 në AZHB

Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes profesionale në AZHB është e dominuar nga punëtorët me përgatitje të lartë profesionale të profilit Agronom dhe Ekonomist.

Nr. rendor	Përgatitja Profesionale	Numri i të punësuarve
1	Bujqësi & Agronom	39
2	Ekonomist	16
3	Jurist	6
4	Veteriner	1
5	Shkenca Kompjuterike/IT	2
7	Shkencat matematikore	1
8	Shkolla e mesme	3
	Gjithsejt	68

Tabela 2: Struktura profesionale e të punësuarve në AZHB

Nr rend	Gjinia e te Punesuarve	Numri
1	Femra	17
2	Meshkuj	51
	Total	68

Tabela 3: Struktura Gjinore e të punësuarve në AZHB

Logjistika

- Me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve për zbatimin e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, gjatë këtij viti (Janar - Dhjetor) kanë qenë në shfrytëzim gjithsej 27 (njëzetë e shtatë) automjete nga zyrtarët e AZHB-së, kryesisht nga Inspektorati Teknik për kontrollin e fermerëve për subvencione dhe grante.

Aktivitet e punës Janar -Dhjetor 2019

- Gjatë kësaj periudhe kemi pergatitur gjithsej 140 kërkesa për servisim të automjeteve;
- Në autoservisin “Kosova Servis” janë gjithsej 48 kërkesa, ndërsa janë pranur 27 fatura, të cilat i kemi proceduar për pagesë;
- Në autoservisin “AGS” janë gjithsej 13 kërkesa, 15 fatura të pranuar të cilat i kemi proceduar për pagesë;
- Në autoservisin “Porche” janë gjithsej 6 kërkesa, ndërsa të pranuar 11 fatura;
- Në autoservisin “Eurogoma” janë gjithsej 30 kërkesa dhe 3 fatura të pranuar;
- Në autoservisin “Sfishta” janë gjithsej 30 kërkesa, ndërsa kemi pranuar 31 fatura të cilat janë proceduar për pagesë;
- Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar edhe 3 fatura të cilat i kemi proceduar për pagesë me para të gatshme për nevojat e ndryshme të zyreve (pajse higjienike etj);
- Kemi pranuar edhe fatura të qirasë nga zyret regjionale (Prizren, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë), të cilat i kemi proceduar për pagesë;
- Kemi pranuar edhe fatura për shpenzimin e energjisë elektrike dhe kemi bërë procedimin e tyre për pagesë (regjioni i Gjilanit 9 fatura, Prizren 7 fatura, Mitrovicë 17 fatura) të cilat i kemi proceduar për pagesë;
- Kemi bërë regjistrimin e 25 automjeteve, pranimin e faturave për kontrollim teknik. Po ashtu kemi pranuar edhe taksat si ato komunale, administrative, rrugore dhe ekologjike, të cilat janë proceduar për pagesë.

loji i automjet	Target	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nentor		Dhjetor		Gjith./lit		Gjith./km		lit/100km
		Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	Litra	Km.	
Shkoda Fabia	32-113-16	40	429	37	1146	114	1324	35	511	29	201	0	137	67	137	110	1169	0	665	0	1026	220	2042	41	298	693	9085	7.627958173		
Kia Sorento	32-166-16	69	196	66	917	128	1418	135	1608	195	1913	140	1496	132	1562	268	2061	281	3140	453	4400	267	3321	192	2098	2326	24130	9.639452963		
Kia Sorento	32-167-16	115	1094	0	0	62	952	127	1631	119	1702	0	85	183	2427	241	2485	0	0	289	3933	301	3125	232	2991	1669	20425	8.171358629		
Kia Sorento	32-168-16	58	638	52	900	207	2041	97	1467	0	0	58	652	175	1889	183	1589	247	2575	222	2928	268	3189	172	1679	1739	19547	8.896505858		
Kia Sorento	32-169-16	0	0	0	0	117	1369	0	286	185	2044	0	0	57	967	193	1632	308	3290	377	4600	371	3985	124	1566	1732	19739	8.774507321		
Kia Sorento	32-170-16	0	0	0	0	121	1115	63	1145	64	798	125	1134	67	977	246	3183	450	4814	293	3547	324	4239	190	1608	1943	22560	8.612588652		
Kia Sorento	32-171-16	167	2290	129	1333	167	1930	187	3090	181	2459	171	1755	166	2246	224	1945	310	3807	331	3518	270	3206	234	3143	2537	30722	8.257925916		
Kia Sorento	32-172-16	0	0	0	0	45	216	0	0	51	733	116	1361	172	2629	232	2397	237	2831	357	4460	0	0	260	2918	1470	17545	8.3784554		
Toyota	32-176-16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	123	63	0	0	226	1203	204	1944	420	2873	362	2964	292	2050	1627	11097	14.66162026		
Shkoda Jety	32-008-16	50	53	0	0	0	0	52	406	0	0	0	0	150	2007	220	2666	323	3676	365	5517	244	4234	221	3089	1625	21648	7.50646711		
Shkoda Jety	32-191-16	0	378	98	1287	55	1330	154	2163	216	3688	53	1729	202	2813	207	2879	299	3453	304	4366	218	2507	108	2309	1914	28902	6.622379074		
Shkoda Jety	32-192-16	0	0	50	478	101	1824	0	514	52	977	166	2060	50	1082	156	1927	244	2842	201	3526	154	2428	153	1787	1327	19445	6.824376446		
Shkoda Jety	32-195-16	90	1148	52	1287	185	2472	96	1899	137	2486	47	246	97	1580	236	3091	246	3967	287	4066	261	3871	143	2432	1877	28545	6.575582414		
Shkoda Jety	32-196-16	0	548	47	593	53	537	96	1398	0	302	100	1921	105	1608	261	3130	252	3191	246	4037	0	0	147	1927	1307	19192	6.810129221		
Shkoda Jety	32-206-16	192	2374	150	2224	162	2058	227	2528	163	2225	159	2307	189	2366	207	2157	165	2442	212	3606	214	2648	206	2677	2246	29612	7.584762934		
Shkoda Jety	32-198-16	53	470	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	200	2366	208	2419	161	2597	53	476	675	8328	8.10518732				
Shkoda Jety	32-199-16	87	1551	31	356	128	1743	46	1401	98	1264	105	1645	156	1948	254	3293	204	3162	256	2971	254	3590	103	3003	1722	25927	6.641724843		
Shkoda Jety	32-200-16	192	2374	0	0	52	955	109	1224	0	351	92	966	214	2876	151	2804	297	4287	244	4052	300	3800	197	2343	1848	26032	7.098955132		
Shkoda Jety	32-201-16	52	1160	84	1527	190	2726	99	1503	100	1740	103	1464	255	3169	202	3256	346	4067	287	4002	237	3978	177	2404	2132	30996	6.878306878		
Kia Sportag	32-305-16	161	1933	106	1940	164	2708	56	758	52	558	221	2437	109	2073	223	2921	279	3555	279	4229	224	2665	167	2370	2041	28147	7.251216826		
Kia Sportag	32-306-16	55	686	51	2228	206	3147	198	2458	256	3458	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	766	11977	6.39559155		
Kia Sportag	32-307-16	159	2544	161	2307	220	2546	163	2866	161	2354	210	2856	294	3305	315	5043	422	5299	424	5574	367	78417	255	3043	3151	116154	2.712777864		
Kia Sportag	32-308-16	172	1712	110	1501	211	3425	211	2253	166	2546	168	2019	114	2620	157	2125	269	3233	370	4513	215	3432	261	3226	2424	32605	7.43444257		
Kia Sportag	32-309-16	62	924	52	619	53	1115	158	2024	96	1566	230	3233	0	0	0	0	269	3621	317	4459	0	0	270	4004	1507	21565	6.988175284		
Kia Sportag	32-310-16	159	2085	55	1246	110	1519	57	41272	301	2147	141	2109	173	2040	303	6222	304	4346	197	2761	163	1809	162	1647	2125	69203	3.070676127		
Toyota LC	32-124-16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	160	0	0	145	879	0	0	0	0	0	0	0	0	145	1039	13.95572666		
Toyota LC	32-231-16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	50	93	0	0	172	1288	443	3148	451	3316	381	3172	0	0	1497	11017	13.58809113		
																											0	0	#DIV/0!	
																											0	0	#DIV/0!	
																											0	0	#DIV/0!	
																											0	0	#DIV/0!	
Totali		#####	#####	1294	20743	2737	37146	2331	73894	2593	35311	2578	31791	3060	42184	5022	60176	6599	79056	7390	93673	5556	143177	4319	54790	696528		0		

Tabela 4: Raporti vjetor i shpenzimeve të karburanteve, 2019

Sektori ligjor

Sektori Ligjor ka vazhduar aktivitetet e planifikuara sipas përgjegjësive të përcaktuara me rregullore, duke u marrë me pjesëmarrje në hartimin e rregulloreve, vendimeve dhe trajtimin e lëndëve me konteste për të cilat janë zhvilluar procedurat e nevojshme ligjore.

Pjesëmarrje aktive në hartimin e U/A për implementimin e programit për PD-në dhe PZHR-në për vitin 2019-të, duke përgatitur vërejtje dhe sygjerime për U/A bazuar në vërejtjet e identifikuar gjatë implementimit të programit e sidomos gjatë procesit të ankimimit dhe procedurave për kthimin e mjeteve të përfituara në mënyrë të paligjshme si dhe futja në program dhe në U/A e kërkesës për garancion bankar për investimet në masën 103 dhe Ujtja e Tokave Bujqësore.

Pjesëmarrje aktive në shqyrtimin dhe përgatitjen e vërejtjeve dhe sygjerimeve për Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, e sidomos në pjesën ku ka të bëjë me AZHB-në.

Janë hartuar një mori vendimesh.

Nr.	Lënda	Përshkrimi
1	Vendime	Gjatë këtij viti janë hartuar draft Vendime për të gjitha Drejtoratet në AZHB dhe Zyrës së Kryeshefit sipas kërkesave të tyre;
2	Përfaqësime gjyqësore	Nga muaji Janar – Dhjetor të vitit 2019-të, është bërë përfaqësimi në 122 (njëqindë e njëzetë e dy) seanca gjyqësore, duke përfshirë çështjet juridiko-civile dhe ekonomike për kontestet e AZHB-së. Përderisa për seancat në çështjet administrative kemi paraqitur parashtrësia për shkak të volumit të madhë të punëve konform nenit 38 par. 5 të LKA-së, (Gjykata mund të vendosë çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme në të cilën palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar);
3	Padi për kthimin e mjeteve financiare	Më kërkesë të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave në AZHB, janë përgatitur 5 (pesë) padi për kthim të mjeteve financiare në gjykatat kompetente, ku më pas me kërkesë të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave është bërë tërheqja e një padie. Kështu që numri totali i padive për këtë vit është 4 (katër);
4	Përgjigje në Padi të ushtruar ndaj AZHB-së	Gjatë vitit 2019-të kemi pranuar 19 (nëntëmbëdhjetë) padi të ushtruar ndaj AZHB-së, ku 17 (shtatëmbëdhjetë) prej tyre janë për çështje administrative dhe 2 (dy) çështje civile. Për të gjitha janë përgatitur dhe proceduar përgjigje në padi, të bashkëngjitur me të gjitha provat relevante për rastin;
5	Përgjigje në Kundër padi	Gjatë vitit 2019-të, kemi hartuar dhe proceduar 3 (tri) përgjigje në kundër padi në gjykatat kompetente, aty ku edhe është duke u zhvilluar procesi gjyqësorë ndaj të paditurëve/kundërpaditësve;
5	Pranim i fajësisë/pajtim gjyqësorë	Gjatë 9 (nëntë) seancave të mbajtura në vitin 2019-të, është bërë pranimi i fajësisë nga 9 (nëntë) të paditur me ç'rast janë arritur 9 (nëntë) pajtime gjyqësore për kthim të mjeteve financiare sipas padisë;
7	Aktgjykimet nga Çështja Administrative Civile dhe Ekonomike	Gjatë vitit 2019-të janë pranuar 48 (dyzetë e tetë) Aktgjykime nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Civile dhe Ekonomike;
8	Ankesa ndaj Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve	Gjatë vitit 2019-të janë hartuar dhe proceduar 21 (njëzetë e një) ankesa ndaj Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Civile dhe Ekonomike;
9	Parashtrësia	Gjatë vitit 2019-të janë hartuar dhe proceduar 35 (tridhjetë e pesë) parashtrësia të ndryshme në gjykatat kompetente, ku janë zhvilluar proceset gjyqësore në kontestet juridiko-civile administrative dhe ekonomike;
	Përgjigje në Ankesa ndaj Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve	Gjatë vitit 2019-të janë hartuar dhe proceduar 8 (tetë) përgjigje në ankesa ndaj Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Civile dhe Ekonomike;

10	Kërkesa për shtyrje të seancave	Gjatë vitit 2019-të janë hartuar dhe proceduar 7 (shtatë) kërkesa për shtyrje të seancave në Gjykatat Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Civile dhe Ekonomike.
11	Fjalë përfundimtare	Gjatë vitit 2019-të janë hartuar dhe proceduar 7 (shtatë) fjalë përfundimtare në Gjykatat Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Civile dhe Ekonomike.
12	Marrëveshje	Gjatë vitit 2019-të është arritur marrëveshje me Qeverinë e Kosovës - Zyra e Kryeministrit, për furnizim me gazetë zyrtare të AZHB-së.
13	Procedura përmbartimit	Gjatë vitit 2019-të janë hartuar dhe proceduar Propozime për Përmbartim për Ekzekutim të 9 (nëntë) Aktgjykimeve tek Përmbartuesi Privat.

Zyra Ligjore ka vazhduar aktivitetet e planifikuara sipas përgjegjësi të përcaktuara me rregullore, me pjesëmarrje në hartimin e rregulloreve, vendimeve dhe trajtimin e lëndëve me konteste për të cilat janë zhvilluar procedurat e nevojshme ligjore.

Janë hartuar një mori vendimesh për implementimin e programit si për Pagesa Direkte ashtu edhe vendime për PZHR-në dhe vendime të tjera për nevoja të AZHB-së sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorive të AZHB-së.

Sa i përket përfaqësimeve gjyqësore në bazë të marrëveshjes me ASH-MD, jemi duke hasur vështirësi për shkak të njoftimit me kohë për ftesat gjyqësore dhe shkresave të lëndëve nga ana e ASH-së, pasi që në bazë të marrëveshjes është dashur t'na dërgohen të gjitha lëndët që janë në kontest gjyqësor dhe që i përkasin AZHB-së, por një gjë e tillë ende nuk është bërë, gjë që paraqet edhe pengesa në mbrojtje të lëndëve gjatë përfaqësimit.

Arkiva

Arkiva e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë gjegjësisht Sektori për Menaxhimin e Dokumentacionit, është përgjegjëse për qarkullimin e dokumentacionit brenda AZHB-së, zyreve regionale dhe jashtë AZHB-së.

Arkiva menaxhon punën e përgjithshme të AZHB-së dhe ndihmon Drejtoritë;

Është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë lidhur me arkivimin e lëndëve;

Si detyrë e Arkivës së AZHB-së është pranimi i të gjitha shkresave të jashtme dhe të brendshme si: Kërkesa, Ankesa, Njoftime, Vendime, Raporte, Aktvendime, Aktgjykime si dhe shumë shkresa të tjera të cilat protokolohehen, skanohen dhe u dërgohen në mënyrë elektronike zyrtarëve dhe fermerëve përkatës.

Po ashtu Arkiva bënë distribuimin e shkresave të ndryshme në mënyrë fizike si: Posta, Ministri të ndryshme, Përmbarues, Gjykatë etj;

Arkiva siguron mirëmbajtjen e regjistrave gjithëpërfshirës për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe ofron informata statistikore dhe të tjera për udhëheqësin e drejtorisë dhe organet e jashtme sipas kërkesës.

Tani në mënyrë tabelare janë të paraqitura të gjitha ankesat, kërkesat dhe vendimet.

Departamenti	Titujt	Numri gjithsej
<u>KRYESHEFI</u>	Raportet Javore	
	Proces Verbali nga Mbledhja e AZHB-së	1
	TOTAL	<u>1</u>
<u>PZHR</u>	Kërkesë	3
	Lista e Përfituesve	22
	Informata	1
	Ankesë	3
	Vendime për shqyrtimin e Ankesave	2
	Raport i Komisionit për shqyrtim të Ankesave v.2017	1
	Propozim Ndryshimet në Programin e PD-2019 duke u bazuar në vështirësitë e hasura gjatë zbatimit PZHR v.2018	1
	TOTAL	<u>33</u>
<u>DA</u>	Kërkesë	8
	Konfirmime	11
	Lista e Përfituesve	8
	Njoftime	11
	Vendime	11
	TOTAL	<u>49</u>

	Kërkesë	1
	Lista e aplikacioneve për kontrollë të dytë	19
	Lëndët e kthyer nga kontrolli në teren	35
	Kthim i lëndës nga rikontroli	1
	Plani i punës për v.2019	1
	TOTAL	<u>57</u>
<u>PD</u>	Kërkesë	1
	Kërkesë për Pagesë	3
	TOTAL	<u>4</u>
<u>ZYRA LIGJORE</u>	Aktvendime nga Gjykata	2
	Aktgjykime nga Gjykata	3
	Thirrje per shqyrtime të lëndës nga Gjykata	9
	Përgjigje në Padi për Gjykatë	6
	Fjalë përfundimtare nga Gjykata	1
	Padi për kthimin e mjeteve për Gjykatë	1
	Pajtime Gjyqësore	2
	Proces verbal i shqyrtimit Gjyqësor	1
	TOTAL	<u>29</u>
<u>PERSONELI</u>	Vërtetime	1
	Raporte mujore për zyrtarët me Marrëveshje të Veçanta	24
	Marrëveshje dhe Vendime për zyrtarët me Marrëveshje të Veçanta	38
	Njoftime për zyrtarët me Marrëveshje të Veçanta	2
	TOTAL	<u>65</u>
<u>NIF</u>	Kërkesë	23
	Përgjigje në Kërkesë për Fermerë	8
	TOTAL	<u>31</u>
<u>TË TJERA</u>	Autorizim	20
	Kërkesa interne	30
	Memorandume zyrtare	2
	Raporte vjetore	2
	Raporte interne	1
	Parashtresë për Propozim të lëndëve	1
	TOTAL	<u>56</u>
	TOTAL	325

Tabela 5 Ankesat, kërkesat dhe vendimet

Zyra e informimit

Gjatë periudhës 01.09.2019 deri më 31.12.2019, në Sektorin e Informimit, është pranuar 1 (një) kërkesë për qasje në dokumente publike, për të cilën kemi kërkuar opinion nga Agjencia për Informim dhe Privatësi. Kërkesa në fjalë është shqyrtuar edhe nga Agjencia për Antikorrupsion në bashkëpunim me Zyrtaren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të Zyrës Ligjore në AZHB. Gjatë kësaj periudhe disa mujore, kemi pranuar një e-mail nga Qendra e Biznesit Kulla Naberezhnaya – Federata Ruse, lidhur me dy fermerë shqiptarë të cilët kanë bashkëpunuar me këtë kompani. Kërkesën e tyre e kemi shqyrtuar dhe brenda afatit ligjor u’a kemi kthyer edhe përgjigjen. Kemi pasur edhe pyetje të ndryshme nga ana e gazetarëve të disa mediave vendore, përgjigjet e të cilëve kryesisht i ka përgatitur drejtori Agim Nuha. Meqenëse jam transferuar nga MBPZHR – Zyra e Personelit, kam ndihmuar kolegët e Personelit në AZHB lidhur me shkresat që kanë të bëjnë me këtë sektorë. Kam përgatitur shkresa të ndryshme lidhur me kërkesat e MAP-it dhe ZKA-së. Vazhdoj të punoj për sistemimin e të dhënave të stafit të AZHB-së në sistemin SIMBNJ. Duke pasur parasysh përvojën time disa vjeçare në zyrën e Arkivës në MBPZHR, gjatë muajit dhjetor kam punuar (ndihmuar) dy ditë kolegët e Zyrës së Arkivës në MBPZHR. Kam ndjekur trajnimin “Qasja në Dokumente Publike”, organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi. Nga data 22.11.2019 më është dhënë e drejta e administrimit të rrjetit social facebook të AZHB-së, ku gjatë tërë kohës jam në kontakt me fermerë nga e gjithë vendi.

Të dhënat lidhur me kërkesat

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjeshme
1			1

Tabela 6: Numri i kërkesave të pranuar

Kërkesat e paraqitura	Numri
Në mënyrë elektronike	2
Kopje fizike	
Elektronike dhe kopje fizike	

Tabela 7: Kërkesat e paraqitura

Mënyra e dërgimit të përgjigjeve	Numri
Në mënyrë elektronike	2
Kopje fizike	
Elektronike dhe kopje fizike	
CD	

Tabela 8: Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

Profili	Numri
---------	-------

Gazetarë	1
Shoqëri civile	1
Organizata buxhetore	1
Individë	
Studentë	
Parti Poltike	
Tjera (specifiko)	

Tabela 9: Profili

Artikuj	Numri
Lajm (publikime, komunikata)	13
Intervista	1
Reportazhe	1
Njoftime	2

Tabela 10: Publikimet në ueb

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, bazuar edhe në Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 04-L 090, U/A, si dhe Rregulloren e Brendshme, është themeluar Drejtoria për Buxhet dhe Financa për funksionalizimin e AZHB-së. Kjo Drejtori është krijuar në fillim të vitit 2018 me rekrutimin e Drejtorit për Buxhet dhe Financa dhe njëkohësisht në kuadër të kësaj Drejtorie janë edhe tre zyrtarë tjerë të domosdoshëm për funksionimin e kësaj Drejtorie si: Zyrtari Çertifikues dhe Aprovues i Pagesave, Zyrtari Shpenzues si dhe Zyrtari për Zotimin e Mjeteve. Gjatë vitit 2018-të stafi i kësaj Drejtorie është certifikuar nga Ministria e Financave për mundësinë e qasjes në programin Free-Balance si dhe në Programet e BDMS si mundësi për realizim të pagesave dhe detyrave të ndryshme në kuadër të AZHB-së.

Që nga themelimi kjo Drejtori është marrë me punë dhe detyra në kuadër të AZHB-së, bazuar edhe në Ligjin mbi Financat Publike si dhe standartet për raportim financiar. Gjatë kësaj kohe në kordinim me Kryeshefin e AZHB-së, kemi përgatitur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2020-2022, si dhe kemi bërë qarkoren buxhetore për vitin 2020. Ky Departament në kuadër të punëve dhe detyrave që ka, është marrë edhe me monitorimin dhe kontrollin e shpenzimeve të AZHB-së, për Grante dhe Subvencione si dhe shpenzimeve administrative. Vlenë të theksohet se përkundër certifikimit të stafit nuk kemi qasje në programin Free-Balance i cili na mundëson që t'i kryejmë pagesat në mënyrë të pavarur dhe direkte andaj jemi në pritje dhe planifikojmë se me fillim të vitit 2020 këto pagesa do realizohen nga Drejtoria e Financave në kuadër të AZHB-se pasi që është njëri ndër kriteret e KE-së për akreditim lidhur me menaxhimin e fondeve IPARD. Deri më tani këto pagesa bëhen në kuadër të MBPZHR-së.

Vërejte: Në raport nuk janë paraqitur të dhënat e shpenzimeve pasi që nuk kemi qasje në programin e Free Balance

DREJTORIA I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL

Gjatë vitit 2019 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - Gjegjësisht nga Drejtorati i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural është bërë zbatimi i Programit të Zhvillimit Rural – duke përfshirë masat ,nën-masat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2019.

Këto masa dhe nën masa të Zhvillimit Rural të cilat janë zbatuar gjatë vitit 2019 kanë qenë si në vijim:

Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore

Masa 101 „Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore” duke përfshirë:

1. Sektorin e pemëve drufrutore (mollë, dardhë, kumbull, vishnje, arra, lajthia ,qershia, kajsia, pjeshka dhe ftoni);
2. Sektori i perimeve dhe serrave, përfshirë patatet;
3. Sektori - Depo për ruajtjen e perimeve;
4. Sektori i mishit (trashja e viçave);
5. Sektori i mishit (trashja e derrave);
6. Sektori i qumështit (lopë qumështore);
7. Sektori i qumështit (dele dhe dhi);
8. Sektori- Pikat grumbulluese;
9. Sektori i rrushit;
10. Sektori i vezëve.

Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore

Masa 103 “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore” duke përfshirë:

1. Sektori i përpunimit të qumështit;
2. Sektori i përpunimit të mishit;
3. Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve;
4. Sektori i prodhimit të verës.

Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale

Masa 302 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale” duke përfshirë sektorët:

1. 302.1 Sektori i prodhimit të mjaltit;
2. 302.2 Sektori i prodhimeve bujqësore në ekonomitë familjare;
3. 302.3 Sektori i zhvillimit të aktiviteteve artizanale;

4. 302.4 Sektori i zhvillimit të turizmit rural;
5. 302.5 Sektori Akuakultura /kultivimi i peshkut;
6. 302.6 Sektori rritja e shpezëve për vezë dhe mishë.

Masa: Ujitja e tokave bujqësore

Masa 303: LEADER Zbatimi i strategjive zhvillimore locale - qasja Leader

Kjo masë përbëhet nga tri aktivitete kryesore:

Aktiviteti 1. –“Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve në territoret e GLV-ve të përzgjedhura”;

Aktiviteti 2. -"Hartimi dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal qasja LEADER – për GLV-të e përzgjedhura" dhe

Aktiviteti 3. –“Kooperimi / bashkëpunimi” i cili do të fillohet në një fazë të mëvonshme, pasi që GLV-të të jenë mirë të strukturuar, punonjësit e tyre të jenë trajnuar dhe banorët e territoret e tyre të kenë demonstruar kapacitetet për të përfituar nga ato aktivitete.

Gjithashtu gjatë vitit 2019-të duhet cekur së është realizuar edhe aplikimi për Programin e veçant –Integrimet Socio Ekonomike për fermat e vogla për vitin 2019.

Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë gjegjësisht Djetorati për Miratim e Projekteve të Zhvillimit Rural, ka bërë zbatimin e Programit për Zhvillim Rural për vitin 2019-të, i cili Program do të jetë në proces të zbatimit gjatë vitit 2020-të.

Realizueshmëria e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural ka rrjedhur sipas aktiviteteve dhe planit të paraparë.

Për realizimin e këtij Programi për Zhvillim Rural për vitin 2019-të buxheti i paraparë ka qenë si në vijim:

Masa 101 „Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore” - Sektoret		Vlera në €	% e buxhetit
101.1 Pemët	Për pemë drufrutore	3,000,000	24.00
101.2 Perimet	Serra	3,000,000	24.00
	Depo për ruajtje të perimeve dhe pemëve	500,000	4.00
101.3 Mishi	Trashja (majmëria) e viçave	2,000,000	16.00
	Trashja e derrave	300,000	2.40
101.4 Qumështi	Prodhimi i qumështit nga lopët	2,000,000	16.00
	Prodhimi i qumështit nga delet dhe nga dhitë	700,000	5.60
	Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	200,000	1.60

101.5	Sektori i rrushit	500,000	4.00
101.6	Sektori i vezëve	300,000	2.40
Gjithsejt		12,500,000	100%

Tabela 11: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore – Sektoret




Tabela 12: Grafikoni 1 - Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore - Sipas sektorëve

Nga të dhënat në tabelën nr 1 dhe grafikonin nr 1 përqindjen më të madhe të buxhetit është paraparë për t'u shpenzuar tek sektori për pemë drufrutore dhe serra me nga 24%, pastaj me nga 16% radhiten sektori për trashjen e viqave dhe sektori për prodhimin e qumështit.

Masa 103,, Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore'' - Sektorët përkatës	Vlera në €	% e buxhetit
103.1 Përpunimi i qumështit	1,000,000 €	25
103.2 Përpunimi i mishit	1,000,000 €	25
103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	1,200,000 €	30
103.4 Prodhimi i verës	800,000 €	20
Gjithsejt	4,000,000 €	100%

Tabela 13: Masa 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore - Sektorët përkatës




Tabela 14: Grafikoni 2- Masa 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore - Sektorët përkatës.

Masa 302 „Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale”	Vlera në €	% e buxhetit
302.1. - Prodhimi i mjaltit	800,000	29.62
302.2. - Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	300,000	11.11
302.3. - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	300,000	11.11
302.4. - Zhvillimi i turizmit rural	700,000	25.94
302.5 - Sektori Akuakultura /kultivimi i peshkut	300,000	11.11
302.6 - Sektori rritja e shpezëve për vezë dhe mishë	300,000	11.11
Gjithsejt	2,700,000	100

Tabela 15: Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale




Tabela 16: Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale

Nga të dhënat në tabelën e mësipërme dhe grafikonin për masën 302 përqindja më e madhe e buxhetit është planifikuar për sektorin e prodhimit të mjaltit (29.62%) apo 800,000 euro nga vlera totale 2,700,000 €.

Masa 303 LEADER „Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja Leader”	
303.1 – Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-ve të përzgjedhura	89,000
303.2 – Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal për GLV-të e përzgjedhura	211,000
Aktiviteti 1: “Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura”	78,480
Aktiviteti 2: “Përkrahja për zbatimin e SZHL të GLV-ve”	132,520
Gjithsejt	300,000€

Tabela 17: Masa 303 LEADER Zbatimi i strategjive zhvillimore locale – qasja Leader




Tabela 18: Grafikoni 4 – Masa 303 LEADER Zbatimi i strategjive zhvillimore locale - qasja Leader

Në tabelën e mësipërme dhe grafikonit sa i përket masës 303 – LEADER, Vlera më e madhe për këtë masë është shpenzuar për zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal për GLV-të e përzgjedhura gjithsejt 211,000 € nga vlera totale 300,000 €.

Masa	Vlera në euro	% e buxhetit
Ujitje e Tokave Bujqësore	1,000,000	100%
Gjithsejt	1,000,000	100%

Tabela 19: Ujitje e Tokave Bujqësore

Programi i Veçantë	Vlera në euro	% e buxhetit
Integrimet Socio -Ekonomike	3,000,000	100 %
Gjithsejt	3,000,000	100%

Tabela 20: Programi i Veçantë

Gjithësej buxheti i paraparë për Programin e Zhvillimit Rural 2019

Masat	Vlera në euro	% e buxhetit
Masa 101 "Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore" - Sektorët	12,500,000	60.98
Masa 103 "Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore" - Sektorët përkatës	4,000,000	19.52
Masa 302 "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale"	2,700,000	13.17
Masa 303 LEADER "Zbatimi i strategjive zhvillimore locale" - Qasja Leader	300,000	1.47
Ujitja e Tokave Bujqësore	1,000,000	4.86
Gjithsejt	20,500,000	100 %

Tabela 21: Masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore – Sektorët

Programi I Veçantë - Integrimet - Socio ekonomike	3,000,000	29,62
Gjithsejt	3,000,000	100%

Tabela 22: Programi i Veçantë – Integrimet Socio ekonomike

Procedurat e zbatimit të Projekteve të Zhvillimit Rural Faza e aplikimit

Është aktivitet i cili është kryer në Zyret Regionale të AZHB-së (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Prizren dhe Gjilan). Aplikimi është bërë përmes formës fizike të aplikimit dhe pas dorëzimit të aplikacioneve nga ana e aplikuesve të gjitha aplikacionet janë regjistruar në formë elektronike nga ana e zyrtarëve regjional në (softuerin për menaxhimin e granteve) sipas sektorëve dhe fushave përkatëse të aplikimit.

Afati i aplikimit për PZHR për sektorët përkatës ka qenë si në vijim:

Masa 101 "Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore" duke përfshirë:

Sektori pemët drufrutore (mollë, dardhë, kumbull, vishnje, qershi, kajsi, arra, lajthi, pjeshkë, ftoi);

Sektori perime - serra përfshirë patatet dhe depo për ruajtje të perimeve;

5	Arian	Begaj	38
	TOTALI		418
TOTALI I PËRGJITHSHËM = 2572 / 2 EKIP			1286

Tabela 116: Numri i lëndëve të PZHR të përfunduara nga secili Inspektor veç e veç.

- ✓ Në tabelën më lartë, kemi prezantuar numrin e kontrolleve të granteve të kryer sipas regjioneve dhe inspektorëve, duke i përfshirë edhe Ex-post kontrollet, super kontrollet dhe rikontrollet.
- ✓ Në shumicën e kohës kontrollat janë kryer nga 17 ekipe, të cilët kanë punuar maksimalisht pasi nr. më i madh i inspektorëve është dashur të punojnë në Pagesa Direkte, një pjesë tjetër e tyre kanë punuar në pranim të dokumentacionit për PZHR 2019.

NUMRI DHE PJESËMARRJA E INSPEKTORËVE TË TERENIT NË KONTROLLET E VITIT - 2019

Nr	Emri dhe Mbiemri	Totali i Fermerëve - PD	Totali i Kontrolleve - PD	Totali i Kontrolleve - PZHR	Totali i Kontrolleve- PD dhe PZHR
1	Arton Haliti	144	267	52	319
2	Arsim Qelaj	214	404	79	483
3	Bislim Muja	183	300	91	391
4	Ibush Haxholli	150	365	117	482
5	Blerim Hoti	255	589	/	589
6	Kujtim Zariqi	132	200	93	293
7	Veton Demaj	204	408	/	408
8	Miratim Shala	273	479	/	479
9	Lulzim Kurti	186	289	59	348
10	Korab Demaj	244	416	/	416
11	Valon Hoti	330	479	/	479
12	Islam Shala	252	488	/	488
13	Fidan Hoti	194	374	/	374
14	Sinan Gashi	208	374	/	374
15	Erind Keqmezi	293	648	/	648
16	Xhevdet Hasani	279	532	113	645
17	Kasim Ahmeti	349	554	105	659
18	Abaz Maxhuni	227	445	114	559
19	Shefki Bajrami	49	62	/	62
20	Shkumbin Zhegrova	177	376	104	480
21	Enver Bala	277	559	78	637
22	Jehon Gashi	273	578	/	578
23	Shpetim Rama	269	559	/	559
24	Kushtrim Bilalli	235	498	42	540
25	Millosh Nedelkoviç	37	51	/	51
26	Zharko Petronjviç	63	37	/	37
27	Aleksander Josiq	12	17	/	17
28	Nemanja Matiq	26	29	/	29
29	Blerim Mulliqi	248	600	100	700
30	Avdi Lloçluni	283	626	26	652
31	Florije Tolaj	233	510	/	510
32	Musa Nivokazi	301	639	64	703
33	Adushe Ukshini	255	471	75	546
34	Kimete Jahiu	242	372	/	372
35	Bejtullah Pira	334	435	54	489
36	Burhan Isufi	257	570	21	591
37	Egzon Ismajli	236	426	12	438
38	Muharrem Rushiti	141	226	84	310
39	Enver Ibishi	170	305	93	398
40	Adriatik Haxhimusa	125	234	/	234
41	Halil Hasani	298	567	87	654
42	Trimor Sojeva	328	553	85	638

43	Xhelal Luma	190	371	35	406
44	Burim Hyseni	305	519	/	519
45	Besiana Metushi	285	471	/	471
46	Millorad Andrijevici	36	46	/	46
47	Enver Fetiu	203	288	107	395
48	Naser Berisha	227	347	77	424
49	Shpejtim Arifaj	262	372	104	476
50	Enver Tahiri	207	322	92	414
51	Mexhit Halimi	266	360	/	360
52	Zenel Elshani	316	480	/	480
53	Flamur Berisha	360	568	/	568
54	Edison Telaku	88	133	/	133
55	Arjan Begaj	226	363	/	363
56	Ilir Qabrati	170	282	/	282
57	Jeton Hazrolli	102	180	/	180
58	Getoar Shala	116	171	/	171
59	Rexha Karavida	38	69	/	69
60	Krenar Kryeziu	318	402	/	402
61	Fatijon Gashi	22	44	/	44
62	Canë Delija	286	541	75	616
63	Rasim Rexha	301	636	53	689
64	Tune Hajdaraj	316	635	102	737
65	Shpresa Hadri	227	469	/	469
66	Nesrete Haxhiavdyli	317	585	55	640
67	Zamir Haxhibeqiri	351	696	35	731
68	Isa Koshi	435	720	51	771
69	Mentor Gashi	449	720	/	720

Tabela 117: Numri i lëndëve të përfunduara nga PZHR dhe PD, për secilin inspektorë

Vështirësitë gjatë kontrollit në teren për Projektet e Zhvillimit Rural

Programi - Shpallja e vonshme e thirrjeve për aplikim dhe mosdefinimi i mjaftueshëm i detajeve të nënmasave të ndryshme, mosdefinimi i mjaftueshëm i Programit dhe Udhëzimit Administrativ në aspektin juridik, për këto masa janë vështirësia e parë që i shkaktohet kontrollit. Nuk na krijohet hapësirë për zbërthimin e tyre, sqarimet e duhura, udhëzimet për inspektorë dhe mbajtjen e trajnimeve për të adoptuar rregullat e kontrollit në teren e sidomos me stafin e ri. Po ashtu kur Programi shpallet vonë ne gjithmonë jemi nën presionin e kohës për të arritur sa më shpejtë implementimin e kontrollit të granteve. Mangësitë e përpilimit dhe detajizimit të kriterëve si dhe precizimi i detajeve teknike, shpesh reflektohen gjatë kontrollit në teren dhe në procesin e hartimit të raporteve nga kontrolli në teren i cili bie ndesh me projektin e miratuar. Këtu duhet vënë në pah edhe lëshimet gjatë kontrolleve administrative.

Ndryshimet në nënmasat (sektorët) e reja që janë aplikuar këtë vit, për të cilat ne nuk kemi pasur përgatitjet e duhura as teorike e as në mjete teknike Masa 101 (nën masa 101.3-Përpunim i

prodhimeve bujqësore), masa Speciale dhe Masa e veçantë me ç'rast inspektorët gjatë kontrollit në teren shpesh është dashur të improvizojnë (Matja e trashësisë së gypave, rezervuarëve të ujit, trashësitë e pllakave bazë të betonit si dhe materiale tjera zonat e pa dukshme) dhe kjo paraqet një vështirësi në procesin e kontrollit.

Kërcënimet ndaj inspektorëve dhe presionet e ndryshme gjatë kontrollit në teren edhe pse janë zvogëluar mundë të thuhet se ende nuk është arritur një vetdijësim i mjaftueshëm i popullatës për respektimin e ligjit dhe të organit shtetërorë.

Masat dhe nën masat e reja në Programin për Bujësi 2019, njëkohësisht e kanë shtuar edhe llojllojshmërinë e inspektimeve në teren. Inspektorët e angazhuar në kontrollin e PZHR-ve janë në numër mjaft të kufizuar dhe sipas rregullit duhet të ndërrohen inspektorët e kontrollit të parë (para Miratimit) dhe inspektorët e kontrollit të dytë (para Pagesës).

Në pamundësi të kompensimit të rrezikshmërisë dhe pagesave për punë jashtë orarit të punës dhe vikendeve, është një tjetër dobësi e cila mundë ta ulë motivin për punë efikase.

Mbështetja jo e knaqshme për materiale shpenzuese në zyrë si tonera për kompletimin e raporteve të kontrollit (në pa mjaftueshmëri të ngjyrës së tonerit, ndodh që të del ndonjë foto nga printeri jo shumë e kjart për ndonjë objekt të fotografuar), vonesat në servisim të veturave, vonesat në regjistrimet e tyre dhe cilësia e ulët e servisimit të automjeteve, etj. Këto dobësi ndikojnë në motivin e punës së inspektoratit.

Vonesat në aplikim, të gjitha këto janë dobësi të cilat vitin në vazhdim presim të përmirësohen dhe të kthehen në avantazhe.

1	PAGESA DIREKTE	10341
2	PROJEKTE TË ZHVILLIMIT RURAL	1286
3	TOTALI	11627

Tabla 118 Numri total i aplikanteve të kontrolluar gjatë vitit – 2019

Të arriturat

Bazuar në të gjitha rrethanat, kontrolli është realizuar me efektivitet dhe efikasitet të lartë teknik - profesional dhe moral, prandaj nuk kemi pasur probleme të theksuara në procesin e kontrollit. Përkundër vështirësive në këtë vit kemi ngritje cilësore në procesin e kontrollit dhe hartimit të raporteve, pasi që raportet nga tereni janë shumë më konkrete dhe më të kompletuara me të dhëna për investimet e realizuara nga përfituesit e granteve dhe gjendjen në teren.

Sipas rekomandimit (të gjeturave) të auditorëve për të dhënat që duhet të përmbaj raportit dhe evitimi i dobësive tjera, me një angazhim maksimal është rritur përmirësim në raportet e kontrollit.

Është përmirësuar në një masë edhe çësja e inspektorëve për kontrollë, me ç'rast gjatë vitit 2019, kemi pasur më pak raste të ankesave nga fermerët. Ndonëse ka pasur këkesa për pasivizimin e NIF, për ndërrime të lokacionit të vendinvestimit për shkaqe të ndyshme dhe për zgjatjen e afateve për implementimin e PZHR.

Nga Sektori i Kontrollit tek drejtoritë përkatëse lëndët janë proceduar brenda afateve ligjore dhe për asnjë moment nuk kemi shkaktuar vonesa apo vështirësi në procesin e procedimit të lëndëve tek sektorët tjerë.

Edhe sistemi elektronik i pranimit - dorëzimit të lëndëve ka funksionuar shumë më mirë këtë vit në krahasim me vitin e kaluar.

Në masë të madhe është vërejtur ulje e shkallës për tentim të mashtrimit nga përfituesit e projekteve.

Konkluzionet dhe rekomandimet

1. Efikasiteti dhe cilësia e veprimit të kontrollit në teren, mund të themi se janë brenda kriterëve kualitative. Kjo arsyetohet me faktin se raportet e hartuara nga inspektorati kanë qenë reale dhe brenda kriterëve të parapara për kontrollin në teren, ka raste që për shkak të volumit të madh të inspektimeve dhe lodhjes sidomos gjatë pasditës mund t'ju përvjedhet ndonjë gabim dhe e tërë kjo qëndron brenda suazave të punës.
2. Rritja në cilësi e performacës edhe më tutje ka vend në punën e inspektoratit dhe të gjithë neve,
3. Kushtet e punës dhe ambienteve të zyreve si dhe paisja me mjete të nevojshme të inventarit, automjeteve si dhe IT është përmirësuar në vitin 2019.
4. Reforma në nr. të inspektorëve dhe profilizimit të tyre për projekte të caktuara do të rritë performancën e inspektorëve dhe krahas kësaj do të rritet edhe cilësia, efikasiteti dhe do të zvogëlohet rreziku dhe koha e kryerjes së lëndëve të PZHR.
5. Pagesa e rrezikshmërisë për Drejtorinë e Kontrollit si masë motivuese në përmirsimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës, bazuar në rreziqet, presionet dhe kërcënimet nga fermerët gjithashtu edhe nga bartja e sëmundjeve të ndryshme transmiseve të inspektorët gjatë kontrollit të kafshëve, shpezëve dhe pickimi i rriqrave.
6. Inicimi i procedurave për mbrojtjen me ligj të inspektoratit para kërcënimeve dhe kërcënuesve, gjatë kontrollit në teren, përkatësisht nga sektori ligjor i AZHB-së dhe MBPZHR të ketë vëmendje më të madhe se deri ku po arrijnë procedurat e inicuar nga vet inspektorët në momentin e kërcënimit tek organet gjegjëse etj.
7. Të planifikohet ulja e përqindjes (zvogëlimi i mostrës) së kontrollit të masave të Pagesat Direkte, meqë normat e larta të kontrollit për Pagesa Direkte dhe vonesat në përgatitjen e Programit në tërësi çrregullojnë tërë ritmin e punës në AZHB.

Përfundimi

Shpallja e vonshme e Programeve, është problem themelorë me të cilin ballafaqohet AZHB, në mënyrë kronike. Të gjitha procedurat e shumta që ekzistojnë nga aplikimi e deri në finalizim të projektit dhe afatet e shkurtëra të realizimit të projekteve, i dyfishojnë problemet dhe mangësitë e veçanërisht në Procesin e Kontrollit. Marrë parasysh këtu, shtimin e masave të reja, mangësitë tekniko - juridike të Programeve, mangësitë në mjete tekniko - profesionale, megjithatë, mundë të konkludojmë, se Drejtoria e Kontrollit, ka realizuar suksesshëm punët dhe detyrat e parashtruara. Lëndët nga Drejtoria e Kontrollit tek Drejtoritë përkatëse janë proceduar brenda afateve ligjore dhe për asnjë moment nuk kemi shkaktuar vonesa apo vështirësi në procesin e procedimit të lëndëve tek sektorët tjerë.

Bazuar në të gjitha rrethanat, bazën Ligjore - Juridike, Programore dhe Parametrat tjerë të angazhimit dhe operimit lirisht mundë të themi se kontrolli në teren është realizuar me efektivitet të lartë teknik dhe profesional, prandaj nuk kemi pasur probleme të theksuara në procesin e kontrollit.

Angazhimi maksimal në plotësimin e rekomandimeve (të gjeturave) të auditorëve për të dhënat që duhet të përmbajë raporti dhe evitimi i dobësive tjera.

Marrë në tërësi në rrethanat aktuale të funksionimit të MBPZHR-së dhe AZHB- së, punët janë kryer sipas planit të paraparë në nivel të mirë sasiorë dhe cilësorë dhe me përgjegjësi të duhura. Me një qasje më pozitive dhe me një mbështetje më të madhe të institucioneve menaxhuese në të ardhmen, besojmë të rritet akoma më tepër funksionaliteti profesional dhe cilësia në punë.

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (IT)

Hyrje

Gjatë vitit 2019-të Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë si:

- Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR);
- Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS);
- sLPIS - Mobile i cili përdoret për kontrollë në teren për sipërfaqe;
- Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin këto module:
 - ✓ Moduli për aplikim në zyret komunale dhe
 - ✓ Moduli për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB;
- Regjistri për Menaxhimin e Granteve i cili përfshin këto module:
 - ✓ Moduli për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë të granteve;
 - ✓ Moduli për menaxhimin e granteve;
 - ✓ Moduli për autorizimin e pagesave të granteve;
 - ✓ Moduli i kontrollit në teren për projekte të zhvillimit rural;
- Softueri për indikator si dhe
- Ueb faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Drejtorja e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë duke përfshirë edhe 7 (shtatë) Zyret Regjionale. Gjatë vitit 2019 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë menaxhimi e të gjithë shfrytëzuesëve (usereve) të domenit të zyrtarëve të Agjencisë për krijimit të llogarive zyrtare dhe vazhdimin e tyre për qasjen në domenin shtetërorë. Të gjithë zyrtarët e AZHB-së janë të qasur në server (share folder) për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Drejtoria e IT bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Regjistrin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet menaxhimi i granteve, moduli i aplikimit për grante dhe plotësimi i kërkesës për pagesë në zyret regjionale të AZHB-së, autorizimi i pagesave të granteve dhe moduli i kontrollit në teren) gjithashtu edhe ruajtja (backup) e të dhënave të serverit ku është i instaluar Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR), ruajtja (backup) i të dhënave të Regjistrit për Menaxhimin e Pagesave Direkte si dhe ruajtja (backup) i të dhënave të Sistemit të Thjeshtësuar për Identifikimin e Parcelave të Tokës (sLPIS).

Drejtorja e IT gjatë vitit 2019-të ka bërë përgatitjen e kampanjës për aplikim për vitin 2019 për Projekte të Zhvillimit Rural, sipas masave dhe nënmasave të caktuara në Udhëzimin Administrativ për Projekte të Zhvillimit Rural, si dhe përgatitjen e regjistrit për vlersimin, miratimin dhe kontraktimin e projekteve. Pas përgatitjes së regjistrit për aplikim është bërë trajnimi i zyrtarëve regjionla të AZHB-së për regjistrimin e aplikacioneve në sistem si dhe u është dhënë mbështetje gjatë gjithë kohës së regjistrimit të aplikacioneve. Për Pagesa Direkte gjatë vitit 2019 është bërë përgatitja për aplikim përmes Regjistrit për Menaxhimin e Pagesave Direkte, i cili përfshinë dy module: Moduli për aplikim në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB. Është bërë përgatitja për aplikim për të gjitha llojet e subvencioneve

për vitin 2019 si dhe është bërë përgatitja e Sistemit të Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS), ku është bërë kopjimi komplet i të gjitha parcelave të vitit 2018 në vitin 2019 (për të lehtësuar aplikimin e fermerëve). Pas përgatitjes së kampanjës për aplikim për vitin 2019 është bërë trajnimi i zyrtarëve komunal dhe u është dhënë mbështetje direkte zyrtarëve komunal gjatë regjistrimit të aplikacioneve gjatë gjithë kohë së kampanjës për aplikim. Po ashtu gjatë vitit 2019 është përgatitur kampanja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e parë TM1 dhe gjashtëmujorin e dytë TM2.

Gjatë vitit 2019 Drejtoria e IT bërë mirëmbajtjen dhe monitorimin e 2 blade enclosure, 7 blade server, 2 MSA storage, 2 External Ethernet Switches, 1 unitreds, 1 ultrium tape drive.

Gjatë vitit 2019 në Regjistrin e Granteve përkatësisht në modulën për miratimin e granteve është përdorur forma e dërgimit të sms në mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në e-mailin e fermerit për t'u njohur lidhur me vendimin e marrë për aplikacionin e tij. Gjithashtu e njëjta formë e dërgimit të sms-ve dhe vendimit është përdorur edhe tek Regjistri i Pagesave Direkte.

Gjatë vitit 2019 Drejtoria e IT ka bërë administrimin e të gjithë regjistrave që shfrytëzon AZHB-ja.

Në këtë skemë mund të shihet lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)




Fig. 2 - Skema e lidhjes së regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Në këtë skemë mund të shihet Sistemi i Komunikimit të AZHB-së, databazat dhe komunikimi i rrjetit të internetit në mes të AZHB-së dhe Ministrisë së Administratës Publike përkatësisht Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) gjatë vitit 2019.




Fig. 3 - Sistemi i komunikimit të AZHB-së, baza e të dhënave të AZHB-së si dhe komunikimi i rrjetit në mes AZHB-së me ASHI

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) do të thotë listë e kompjuterizuar e të dhënave të hartuara nga ana e institucionit përkatës brenda MBPZHR-së dhe AZHB-së me qëllim të identifikimit të fermerëve që mund të përfitojnë nga mbështetja financiare nga autoritetet kombëtare dhe burime të tjera, si dhe fermerët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në bazë vullnetare. Regjistrimi i fermerëve është i rregulluar me "Udhëzim Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerëve" regjistrimi është vullnetar, obligativ është vetëm për fermerët që aplikojnë për grante dhe subvencione. Gjatë vitit 2016 është bërë plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerëve.

Regjistri elektronik i fermerëve (eFR), Databaza e eFR-së është e instaluar në server të Agjencisë, ku serveri është i hostuar në dhomën e servereve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike dhe gjatë gjithë kohës është funksional. Regjistrimi i fermerëve bëhet në zyret komunale në Drejtoratet e Bujqësisë dhe në Zyret Regjionale të AZHB-së. Krijimi i përdoruesve dhe administrimi i këtij regjistri bëhet nga Drejtorati i Regjistrave varësisht sipas pozitës së zyrtarit që duhet të ju krijohet përdorimi.

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) ka filluar të funksionoj në vitin 2012 dhe gjatë këtij viti janë regjistruar 16,608 fermerë. Në vitin 2013 kane qenë të regjistruar 26,603 fermer, në vitin 2014 34,775 fermerë, në fund të vitit 2015 43166 fermerë, në fund të vitit 2016 50164 fermerë. Në fund të vitit 2017 numri i fermerëve të regjistruar në eFR ka arritur në 55448, në fund të vitit 2018 ka arritur në 61017 fermerë, ndërsa në fund të vitit 2019 përkatësisht deri me datë 31.12.2019 numri i fermerëve të regjistruar ka arritur në 66224 fermerë në 37 komuna të Kosovës.

Gjatë vitit 2019 u është dhënë mbështetje direkte zyrtarëve komunal dhe regional të AZHB-së për regjistrimin e fermerëve në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR).

Më poshtë në këtë diagram mund të shihni dallimet e numrit të fermerëve nëpër vite të regjistruar në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR):




Tabla 119 Grafikoni 35 Numri i fermereve në vite

Në Regjistrin Elektronik të Fermereve (eFR) përfshihen të dhënat për fermerin, tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, mekanizmi bujqësorë si dhe nënshkrimi i fermerit.

Për fermerin i kemi të dhënat për emrin, mbiemrin, emrin e babës, datëlindjen, numrin personal, gjuhën e fermerit, komunën, vëndbanimin, telefonin, e-mailin, koordinatat e fermës që merren nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) emri i bankës dhe numri i xhirollogarisë, etj.

Për tokën në shfrytëzim i kemi të dhënat për tokën e punueshme si ara, kopshte, lëndinë e përherëshme, pemishte, vreshta, pyje, të dhënat plotësohen për sipërfaqen e tokës në pronë në ha dhe sipërfaqën e tokës në huazim me qera, patate mbi 10 (dhjetë) ha, drithëra mbi 50 (pesëdhjetë) ha, bimë industriale, hortikulturë e hapur mbi 3 (tre) ha, hortikulturë e mbuluar mbi 0.30 (zero pikë tridhjetë) ha.

Për kafshë i kemi të dhënat për lopë qumështore, mëshqerra (mbi dy vite), dema (mbi dy vite), një deri në dy vite meshkuj, një deri në dy vite femra, dele për mbarështim, dele (desh, qingja, rrunza), dhi për mbarështim, dhi (cjep, keca, ftuja), derra nën 20 (njëzet) kg, dosat për mbarështim mbi 50 (pesëdhjetë) kg, derra tjerë, kuaj, gomarë, pula, zogjë, bletë etj.

Për mekanizëm i kemi të dhënat për traktorë, motokultivatorë dhe autokombanja dhe është pjesa e nënshkrimit ku në këtë pjesë përfshihen të dhënat për datën e regjistrimit dhe vendin e regjistrimit.

Pas regjistrimit të fermerit gjenerohet NIF, "NIF" d.t.th. Numri Identifikues i Fermës.

Pasi të bëhet gjenerimi i NIF-it është e mundur shtypja e çertifikatës së fermerit dhe aneksit me të dhënat e fermerit ku në aneksin e eFR-së nënshkruhet zyrtari përgjegjës gjatë regjistrimit dhe fermeri.

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) është i lidhur me Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku nuk mund të kalohet në sLPIS pa qenë i regjistruar në eFR.

Në skemën e mëposhtme mund të shihet procesi i regjistrimit të fermerit në eFR




Fig. 4 - Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR

Me poshtë mund të shihni Regjistrin Elektronik të Fermëve (eFR) i cili është ueb-aplikacion dhe funksionon në tri gjuhë: Shqip, Anglisht dhe Serbisht

Fig. 5 - Regjistrin Elektronik i Fermëve

Në eFR është i nderlidhur sLPIS-i (Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) dhe Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku pasë regjistrimin ne eFR te dermerit kalohet ne menyre automatike ne sLPIS për digjitalizim te parcelave te tokes, po ashtu në menyre autoatike kalohet ne Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku bëhet aplikimi për të gjitha llojet e pagesave direkte.

Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS)

Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) përmes këtij sistemi gjatë vitit 2019 është bërë aplikimi për 49 kultura bujqësore ato janë: kultuara lavërtare 7 (grurë, farë gruri, misër, luledielli, elb dhe thekra) për perime në fushë të hapur për 25 kultura (lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan i zi, tranguj, patate, shalqinjë, pjepër, kungulleshë, kunguj misri, asparagu, brokoli, fasule monokulturë, bizele, kungulli, speci, marulla, majdanozi dhe rrepka) dhe për 16 kultura pemëtare permanente (molla, dardha, ftoi, mushmolla, kumbulla, kajsia, arra, lajthia, aronia, pjeshka, qershia, vishnja, dredhëza, manaferra, mjedër dhe boronica) si dhe vreshtat egzistuese. Pas hapjes së kampanjës për vitin 2019 janë trajnuar zyrtarët komunal për dixhitalizimin e parcelave dhe u është dhënë mbështetje direkte gjatë dixhitalizimit të parcelave gjatë kohës së aplikimit të fermerve për mbështetje direkte për sipërfaqe. Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) është i nderlidhur me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit ku jemi duke i shfrytëzuar të dhënat për zonat kadastrale, kadastrin e parcelave, lumenjtë dhe hekurudhat.

Më poshtë mund të shihni se si duket lidhja e sLPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit:




Fig. 6 sLPIS dhe ndërlidhja me Agjencinë Kadastrale përmes Geoportalit

Në këtë skemë mund të shihet funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE




Fig. 7 Funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE

Aplikimi i fermerve për mbështetje ka qenë në rritje të vazhdueshme ndër vite. Më poshtë do t'i paraqesim aplikimet e tyre.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2011) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,825 fermerë dhe janë dixhitalizuar 37,891 parcela me grurë me 43,008.02 ha. Ndërsa për misër kanë aplikuar 2,341 fermerë dhe janë dixhitalizuar 5,989 parcela me misër me 5,983.72 ha dhe për luledielli kanë aplikuar 32 fermerë dhe janë dixhitalizuar 87 parcela me luledielli me 769.79 ha.

Totali i parcelave të dixhitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 është 43,967 ndërsa i hektarve 49,761.53 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2012) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,728 fermerë dhe janë dixhitalizuar 49,106 parcela me grurë me 53,933.52 ha. Ndërsa për misër kanë aplikuar 3,726

fermerë dhe janë dixhitalizuar 11,202 parcela me 10,233.85 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 31 fermerë dhe janë dixhitalizuar 73 parcela me 487.12 ha.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 është 60,381 ndërsa i hektarve 64,654.49 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,781 fermerë dhe janë dixhitalizuar 50,168 parcela me 52,003.32 ha. Ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermerë dhe janë dixhitalizuar 41 parcela me 439.11 hektar, për misër kanë aplikuar 6,084 fermer dhe janë digjitalizuar 16,726 parcela me 15,171.26 hektar, për luledielli kanë aplikuar 14 fermer dhe janë digjitalizuar 37 parcela me 653.69 hektar dhe me perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,950 fermer dhe janë digjitalizuar 5,770 parcela me 3,889.05 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 është 72,742 ndërsa i hektareve 72,156.43 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,993 fermer dhe janë dixhitalizuar 46,905 parcela me 47,289.34 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermerë dhe janë dixhitalizuar 49 parcela me 417.89 hektar, për misër kanë aplikuar 8,336 fermerë dhe janë dixhitalizuar 24,123 parcela me 21,091.00 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermerë dhe janë dixhitalizuar 23 parcela me 304.57 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,738 fermer dhe janë dixhitalizuar 8,959 parcela me 5,870.85 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 4,291 fermer dhe janë dixhitalizuar 7,700 parcela me 4,567.97 hektar.

Totali i parcelave të dixhitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 është 87,759 ndërsa i hektareve 79,541.62 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,859 fermer dhe janë dixhitalizuar 55,008 parcela me 52,722.66 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 26 fermer dhe janë dixhitalizuar 72 parcela me 775.78 hektar, për misër kanë aplikuar 7,978 fermer dhe janë dixhitalizuar 24,091 parcela me 20,044.2 hektar, luledielli kanë aplikuar 2 fermer dhe janë dixhitalizuar 2 parcela me 9.88 hektar, për theker kanë aplikuar 76 fermer dhe janë dixhitalizuar 150 parcela me 245.08 hektar, për elb kanë aplikuar 156 fermer dhe janë dixhitalizuar 329 parcela me 285.14 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 5,439 fermer dhe janë dixhitalizuar 10,359 parcela me 7294.75 hektar, per bujqësi organike kanë aplikuar 7 fermer dhe janë dixhitalizuar 43 parcela me 111.9 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 5,795 fermer dhe janë dixhitalizuar 9,284 parcela me 5,368.18 ha.

Totali i parcelave të dixhitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 është 99,338 ndërsa i hektareve 86,857.57.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2017 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 9,709 fermerë dhe janë dixhitalizuar 44,669 parcela me 42,381.02 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 11 fermer dhe janë dixhitalizuar 46 parcela me 513.14 hektar, për misër kanë aplikuar 8,598 fermer dhe janë dixhitalizuar 28,120 parcela me 23,914.52 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermer dhe janë dixhitalizuar 9 parcela me 56.33 hektar, për theker kanë aplikuar 78 fermer dhe janë dixhitalizuar 153 parcela me 201.99 hektar, për elb kanë aplikuar 227 fermer dhe janë dixhitalizuar 488 parcela me 423.57 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 5,712 fermer dhe janë dixhitalizuar 11,310 parcela me 7,928.36 hektar, per bujqësi organike kanë aplikuar 13

fermer dhe janë dixhitalizuar 70 parcela me 149.07 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 7,181 fermer dhe janë dixhitalizuar 11,604 parcela me 6,805.51 hektar.

Totali i parcelave të dixhitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2017 është 96,469 ndërsa i hektareve 82,373.51 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2018 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,674 fermer dhe janë dixhitalizuar 50,844 parcela me 47,303.09 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 11 fermer dhe janë dixhitalizuar 50 parcela me 464.34 hektar, për misër kanë aplikuar 8,416 fermer dhe janë dixhitalizuar 28,036 parcela me 23,370.36 hektar, luledielli kanë aplikuar 5 fermer dhe janë dixhitalizuar 8 parcela me 7.91 hektar, për theker kanë aplikuar 83 fermer dhe janë dixhitalizuar 158 parcela me 240.81 hektar, për elb kanë aplikuar 315 fermer dhe janë dixhitalizuar 694 parcela me 570.80 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 6,878 fermer dhe janë dixhitalizuar 13,260 parcela me 9,080.23 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 37 fermer dhe janë dixhitalizuar 156 parcela me 420.24 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 8,050 fermer dhe janë dixhitalizuar 12,735 parcela me 7,833.94 hektar.

Totali i parcelave të dixhitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2018 është 105,941 ndërsa i hektareve 89,291.72 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2019 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,833 fermerë dhe janë dixhitalizuar 40,341 parcela me 38,193.92 ha. Ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 15 fermerë dhe janë dixhitalizuar 58 parcela me 578.56 ha, për misër kanë aplikuar 9,497 fermerë dhe janë dixhitalizuar 34,396 parcela me 28,959.33 hektar, luledielli kanë aplikuar 5 fermer dhe janë dixhitalizuar 8 parcela me 7.91 hektar. Për theker kanë aplikuar 70 fermerë dhe janë dixhitalizuar 147 parcela me 214.98 ha, për elb kanë aplikuar 273 fermerë dhe janë dixhitalizuar 654 parcela me 523.65 ha, për tërshërë kanë aplikuar 505 fermerë dhe janë dixhitalizuar 1087 parcela me 1051.15 ha, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 7,460 dhe janë dixhitalizuar 14,059 parcela me 9,381.99 ha. Për bujqësi organike kanë aplikuar 25 fermerë dhe janë dixhitalizuar 247 parcela me 814.56 ha dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 7,273 fermerë dhe janë dixhitalizuar 11,776 parcela me 7,891.36 ha.

Totali i parcelave të dixhitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2019 është 102,966 ndërsa i hektarëve 87,618.5.

Në këtë grafikun mund të shihet numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipërfaqen e dixhitalizuar gjatë kampanjave për aplikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019:




Tabela 120: Grafikoni 36 - Numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS, numri i parcelave dhe sipërfaqja e digitalizuar nëpër vite

Më poshtë mund të shihni Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS):




Fig. 8 Sistemi i Thjeshtësuar për Identifikim të Parcelave të Tokës (sLPIS)

Për kontrollë në teren nga inspektorët e AZHB-së përdoren sLPIS-Mobile i cili funksionon pa qasje në rrjet të internetit (offline) ku ngarkohen të dhënat nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) në sLPIS-Mobile vetëm me qasje të llaptopit në rrjet qeveritar dhe bartja e të dhënave nga sLPIS-Mobile në Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS). Ngarkimi i të dhënave bëhet shumë shpejt me një komandë e cila bën transferimin e të dhënave. Konfigurimi i sLPIS-Mobile në llaptop është bërë nga Drejtoria e IT po ashtu edhe konfigurimi i GPS-ve që përdorin inspektorët në teren.

Më poshtë mund të shihni sLPIS-Mobile i cili funksionon (offline) pa qasje në rrjet të internetit i cili përdoret nga inspektorët për kontrollë në teren




Fig. 9 sLPIS-Mobile

Regjistri i Granteve

Regjistri i Granteve - Ky regjistër përmbanë:

- ✓ Modulin për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë;
- ✓ Modulin e miratimit të granteve;
- ✓ Modulin e autorizimit të pagesave si dhe
- ✓ Modulin e kontrollit në teren.

Regjistri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë

Regjistri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë: Ky modul është instaluar në zyrat regionale të AZHB-së ku bëhet aplikimi sipas masave dhe nënmasave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Gjatë vitit 2019 ruajtja e të dhënave gjatë aplikimit është bërë në server të AZHB-së dhe gjatë gjithë kohës zyrtarët përgjegjës të miratimit të projekteve kanë mundur të shohin të dhënat e fermerëve që kanë aplikuar sipas masave dhe nënmasave dhe shumën e projektit që ka aplikuar. Gjatë plotësimit të kërkesës për pagesë gjatë vitit 2019 janë regjistruar të gjitha faturat që janë sjelluar nga fermerët që kanë bërë kërkesë për pagesë, gjatë gjithë kohës zyrtarët e Autorizimit të Pagesave mund të shohin se sa fermerë kanë bërë kërkesë për pagesë.

Më poshtë mund të shihni Softuerin për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë i cili funksionon në shtatë zyrat regionale të AZHB-së




Fig. 10 Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë

Miratimi i granteve

Miratimi i granteve: Gjatë vitit 2019 Regjistri për Miratimin e Granteve është përgatitur për miratimin e granteve të vitit 2018 sipas Udhëzimit Administrativ 2019. Pas aplikimit në softuerin për aplikim për grante, zyrtarët e AZHB-së fillojnë me poentimin e tyre sipas kriterëve që janë të rregulluara me udhëzimin administrativ të vitit përkatës. Përmes këtij softueri gjenerohen letrat informuese, bëhet përgatitja e kontratës që nënshkruhet nga fermeri dhe AZHB-ja, po ashtu përmes këtij softveri bëhet dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në e-malin e fermerit për t'u njohur lidhur me vendimin e marrë për aplikacionin e tij. **Më poshtë mund të shihni softuerin për miratimin e granteve që shfrytëzohet nga zyrtarët e AZHB-së**




Fig. 11 Softuerin për miratimin e granteve

Autorizimi i Pagesave

Autorizimi i Pagesave - Gjatë vitit 2019 ky modul është përgatitur për Autorizim të Pagesave të vitit 2019 ku kërkesat për pagesë janë plotësuar në zyret regjionale të AZHB-së. Kalkulimi dhe autorizimi i pagesave është bërë nga zyrtarët e Autorizimit të Pagesave ku bëhet kalkulimi i faturave dhe përpilimi i listave për kontrollë në teren dhe përgatitja e listës për pagesë.

Më poshtë mund të shihni softuerin për autorizimin e pagesave që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Fig. 12 Softuerin për autorizimin e pagesave

Moduli i kontrollit në teren

Moduli i kontrollit në teren: Ky modul përdoret nga Drejtoria e Kontrollit në Teren, ku përmes këtij moduli nga Drejtori i Drejtorisë së kontrollit caktohen lëndët për kontrollë në teren dhe përcaktohen për secilën lëndë nga dy (2) inspektorë.

Pas definimit të lëndëve, përmes modulit të inspektorëve, secili inspektor sheh lëndët që i'u kanë caktuar për inspektim. Pas kontrollit në teren inspektorët qasen në këtë modul ku në sistem plotësojnë të gjeturat në teren dhe në mënyrë automatike raporti kalon tek shefi apo personi përgjegjës të Modullit të Kontrollit, ku dhe bëhet vlerësimi/pranimi i kontrollit.

Përgjegjësitë e Drejtorisë së Kontrollit, e bëjnë pranimin e lëndës dhe vlerësimin e raportit të kontrollit në teren dhe pas këtij vlerësimi, lënda bartet në mënyrë automatike tek departamentet përkatëse. Nëse është kontrolli i I-rë, atëherë lënda bartet tek Miratimi i Projekteve, ndërsa nëse lënda është e kontrollit të II-të, lënda bartet tek Autorizimi i Pagesave.

Më poshtë mund të shihni modulin e kontrollit në teren që shfrytëzohet nga inspektorët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB




Figura 13 Moduli i kontrollit në teren

Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte - Ky ueb - aplikacion përfshinë dy module: moduli për aplikim në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB. Përmes këtij ueb - aplikacioni është bërë aplikimi për të gjitha pagesat direkte për sipërfaqe (grurë, misër etj, kultura permanente) si dhe të gjitha aplikimet për krerë (lopë qumështore, dele, dhi, bletë etj.). Ky aplikacion është i ndërlidhur edhe me sLPIS (Sistemi i Thjeshtëzuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) ku pas dixhitalizimit të parcelave bëhet aplikimi përmes këtij ueb - aplikacioni. Në ueb - aplikacionin e pagesave direkte bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve, procedimi i lëndëve për kontroll në teren, kalkulimi i pagesave, përpilimi i listave për pagesë si dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në e-malin e fermerit. Përmes këtij ueb - aplikacioni bëhet komplet menaxhimi i pagesave direkte. Gjatë vitit 2019 Drejtoria e IT në këtë ueb - aplikacion ka bërë krijimin e shfrytëzuesëve (userëve), rikthimin në aplikim të aplikacioneve që kanë bërë gabime zyrtarët komunal gjatë aplikimit si dhe mirëmbajtjen e të dhënave.

Më poshtë mund të shihet Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Name	SubsidySubtypeName	UnitMeasureName	PriceType	Category
Akuakulturë	Tjera	Copë	Fiks	Vjetor
Aronia	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Arra	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Asparagu	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bizele	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bletë	Bletë	Copë	Fiks	Vjetor
Boronica	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Brokoli	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Buallica	Gjedhë	Krerë	Fiks	Vjetor
Bujqësia organike	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Dele për mbarështim	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Dhi për mbarështim	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Domate	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Dosat për riprodhim	Derra	Krerë	Fiks	Vjetor
Dredhëza	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor

Fig. 14 Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Më poshtë mund të shihni aplikacionin për aplikim për Pagesa Direkte për të gjitha subvencionet



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada - Government
 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencia za Razvoj Poloprivrede/The Agriculture Development Agency

FORMULAR PËR APLIKIM/ OBRAZAC ZA APLIKACIJU
Pagesat Direkte

NIF: 1050486 Nr:30/01266 Viti

1. Zgjidh llojin e entitetit/ Izaberi tip lica? Person Fizik/Fizicko Lice Person Juridik/Pravno Lice

1a. Të dhënat për Personin Fizik (Fermerin)/Podaci o Fizickom Licu (Farmeru)

Emri/ Ime	Test	Mbiemri/ Prezime	Test
Emri i babait/ Ime oca	Test	Data e lindjes/ Datum rođenja	12/12/1980 12:00:00 AM
Numri Personal/ Licni broj	1231231239	Telefoni/ Telefon	044/000/000
Komunal/ Opština	Prishtinë/ Pristina	Vendbanimi/ Naselje	Prishtinë/ Pristina

1b. Të dhënat për Personin Juridik/ Podaci o Pravnom Licu

Emri i Personit Juridik/ Ime Pravno Lice			
Nr. Reg. Biznesit/ Reg. broj Biznesa	0	Nr. Fiskal/ Fiskalni broj	0

II. Aplikacioni është komplet/ Aplikacija je kompletna PO JO

Në rast të mungesës së dokumenteve aplikanti do të dorëzojë dokumentet përkatëse brenda një periudhe prej 5 ditë pune!
 U slučaju nedostataka dokumentacije aplikant će predati dokumente u okviru perioda od 5 radnih dana!

Grurë	Hektar	0.41
Domate	Hektar	0.80
Pemë molle	Hektar	0.48
Lopë qumështore	Krerë	5.00
Dele për mbarëshëm	Krerë	150.00
Dhi për mbarëshëm	Krerë	10.00

- Deklaratë:
 1. Konfirmoj që të gjitha të dhënat e ofruara në këtë aplikacion janë korrekte dhe unë do të ballafaqohem me pasojat ligjore në rast se të dhënat nuk janë të sakta apo mungojnë.
 2. I vë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe informatat për kontrollet në teren.
 3. Unë lejoj përdorimin e këtyre të dhënave në të gjithë regjistrat e MBPZHR dhe ESK.

- Izjava:
 1. Potvrdjujem da svi podaci u ovoj aplikaciji su korektni i tačni i da ću snositi zakonske posledice ako su podaci netačni i neistiniti ili nedostaju.
 2. Ja učiniću dostupnim sve podatke i informacije za terensku kontrolu.
 3. Dajem saglasnost da se ovi podaci upotrebe u registre MPSRR i SOK.

Viti

dita/dan		muaji/mesec		viti/god	
----------	--	-------------	--	----------	--

(Nënshkrimi i aplikantit / (personit të autorizuar)
 (Potpis aplikanta / (ovlačenog lica)

(Nënshkrimi i zyrtarit komunal)
 (Potpis optinskog slubenika)

NIF: 1050486

Faqe/Strana 1 nga/od 1

Datë/ Datum:

Fig. 15 Aplikacionin për aplikim për Pagesa Direkte

Ueb faqja

Ueb faqja: Mirëmbajtja e ueb faqës së AZHB-së bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë Informative. Gjatë vitit 2019 janë publikuar të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikues, udhëzimet administrative si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Publikimi i këtyre informatave është bërë në gjuhën Shqipe dhe Serbe.

Republika e Kosovës
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

SHQIP ENGLISH SRPSKI

BALLINA PËR NE LAJME DREJTORATET LEGJISLACIONI GRANTE SUBVENCIONE SHPALLIE

THIRRJE PËR APLIKIM - GRANTE

THIRRJE PËR APLIKIM - SUBVENCIONE

LISTA E PËRFITUESVE TË GRANTEVE

LISTA E PËRFITUESVE TË SUBVENCIONEVE

Publikohen rezultatet preliminare të granteve në bujqësi për disa sektorë

Drejtoria i Autorizimit të Pagesave organizoj trajnim për fermer

Publikohen rezultatet preliminare të granteve në bujqësi për disa sektorë

Zgjatet deri më 10 prill afati për aplikim për Pagesa Direkte

Fig. 17 Ueb Faqja

SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Auditimi i Brendshëm është një aktivitet i pavarur dhe profesional që i ofron menaxhmentit të organizatës siguri të arsyeshme se shpenzimi i fondeve, zhvillimi i procedurave, sistemi i monitorimit dhe qeverisja e përgjithshme bëhen në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe të bazuara në praktikën e mira ndërkombëtare.

Spektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) në kuadër të AZHB-së parashihet me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (i ndryshuar/plotësuar me Ligjin 04/L-090). SAB brenda AZHB-së për herë të parë është themelur në vitin 2018. Aktualisht, SAB funksionon me dy (2) persona: Drejtori i Auditimit dhe një auditore e brendshme.

Bazuar në intervistat e zhvilluara me stafin kyq në fund të vitit 2018 SAB ka përgatitur Planin Strategjik të Auditimit për periudhën pesë-vjeçare 2019-2023 si dhe Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2019 të cilat janë aprovuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së.

Aktivitetet e SAB të kryera gjatë vitit 2019 ndahen në këto kategori:

- I. DETYRAT E AUDITIMIT
- II. DETYRAT E KONSULENCËS
- III. TË TJERA

Detyrat e auditimit

SAB në vitin 2019-të ka kryer tri (3) auditime sipas Planit Vjetor të Auditimit 2019 dhe dy (2) auditime me kërkesë nga menaxhmenti respektivisht nga Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së.

Auditimet sipas Planit Vjetor të Auditimit

Spektori i Auditimit të Brendshëm në vitin 2019 ka ekzekutuar tri (3) auditime të bazuara në Planin Vjetor të Auditimit që kanë mbuluar temat në vijim:

- ✓ Auditimi i nënmasës 101.1 – Spektori për pemë drufrutore – PZHR 2018;
- ✓ Auditimi i nënmasës 101.2 dhe 101.2.1 – Spektori për serra dhe sektori për depo – PZHR 2018; dhe
- ✓ Auditimi i nënmasës 101.3 dhe 101.3.1 – Spektori i mishit (trashja e viçave dhe derrave) – PZHR 2018.

Në kuadër të këtyre auditimeve janë testuar gjithsej 108 mostra, gjegjësisht 53 mostra të aplikuesve të kontraktuar, 36 mostra të aplikuesve të refuzuar dhe 19 mostra të aplikuesve të paprocesuar. Në tabelën në vijim është paraqitur shpërndarja e këtyre mostrave të audituara/testuara sipas secilës temë të auditimit.

#	Tema e auditimit	Mostra të aplikuesve të kontraktuar	Mostra të aplikuesve të refuzuar	Mostra të aplikuesve të paprocesuar	Gjithsej
1	Sektori për pemë drufrutore	16	18	10	44
2	Sektori për serra dhe sektori për depo	25	10	6	41
3	Sektori i mishit	12	8	3	23
Gjithsej		53	36	19	108

Tabela 121: Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet sipas Planit Vjetor

Procedurat e testimit të mostrave kanë përfshirë testimin e kontrollit administrativ respektivisht të dokumentacionit që nga aplikimi deri në autorizimin e pagesave si dhe inspektimet e investimeve në teren.

Auditimet me kërkesë nga menaxhmenti

Sektori i Auditimit të Brendshëm në vitin 2019 ka kryer dy (2) auditime me kërkesë nga menaxhmenti. Auditimet e këtij lloji të kryera në vitin 2019 janë:

- ✓ Auditimi i procesit të kthimit të avanceve për nënmasën 103.3 – Përpunimi i pemëve dhe perimeve – PZHR 2015 dhe
- ✓ Auditimi i granteve nga PZHR 2012-2018.

Në kuadër të këtyre auditimeve janë testuar gjithsej 96 mostra, gjegjësisht 53 mostra të aplikuesve të kontraktuar, 14 mostra të aplikuesve të refuzuar dhe 29 mostra të aplikuesve të paprocesuar. Në kuadër të “Auditimit të granteve nga PZHR 2012-2018” në vitin 2019 janë audituar/testuar vetëm një pjesë (91) e mostrave nga të gjitha masat e PZHR 2012.

Në tabelën në vijim është paraqitur shpërndarja e këtyre mostrave të audituara/testuara sipas secilës temë të auditimit.

#	Tema e auditimit	Mostra të aplikuesve të kontraktuar	Mostra të aplikuesve të refuzuar	Mostra të aplikuesve të paprocesuar	Gjithsej
1	Auditimi i procesit të kthimit të avanceve për nënmasën 103.3 – Përpunimi i pemëve dhe perimeve – PZHR 2015	5	-	-	5
2	Auditimi i granteve nga PZHR 2012	48	14	29	91
Gjithsej		53	14	29	96

Tabela 122: Shpërndarja e mostrave të testuara – auditimet me kërkesë

Sipas kërkesës së menaxhmentit, procedurat e testimit të mostrave për këto auditime kanë përfshirë vetëm testimin e kontrollit administrativ respektivisht të dokumentacionit.

Detyrat e konsulencës

Krahas detyrave të auditimit sipas Planit Vjetor dhe bazuar në kërkesën e menaxhmentit, SAB gjatë tërë vitit 2019 ka ofruar edhe shërbime të konsulencës për menaxhmentin e lartë dhe stafin e AZHB-së.

Në kuadër të këtyre shërbimeve të konsulencës SAB ka ofruar kontributin e vet në aktivitetet në vijim:

- ✓ Përgatitja e Udhëzuesve për Aplikues për PZHR-2019;
- ✓ Përgatitja e një dokument-diskutimi lidhur me “pakon e akreditimit”;
- ✓ Konsulta dhe kontribute të vazhdueshme me ekspertin gjerman të angazhuar në një projekt për asistencë teknike për përgatitjen e AZHB-së për akreditim;
- ✓ Konsultime dhe rekomandime rreth përgatitjes së draft-rregullores për *“Detyrat, Funksionin, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë”*; dhe
- ✓ Konsultime dhe këshillime tjera.

Të tjera

Aktivitetet tjera të kryera gjatë vitit 2019 nga ana e SAB përfshijnë:

- ✓ Pjesëmarrja në trajnime;
- ✓ Koordinimi i auditimit të jashtëm/Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- ✓ Asistencë për përgatitjen e Planit të Veprimit për Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe
- ✓ Përgatitja e Planit Strategjik 2020 - 2023 dhe Planit Vjetor të Auditimit 2020.